[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik kur kërkohet nga autoriteti kontraktor]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti]

### LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial	Numri i faqes dhe pikat e DT që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial	Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial

#### KUJDES

Çdo e dhënë, që nuk është regjistruar si e dhënë konfidenciale, do të konsiderohet se titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës dhe Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për publikimin e këtij informacioni.

Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkeljen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik.



## Shtojca 5

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e \_\_\_\_\_ të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të ekzekutimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

V ula

## Shtojca 6

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË** **Mbi konfliktin e interesave**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

\_\_\_\_\_

**Vula**

## Shtojca 7

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik* ]

### DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilesinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP<sup>2</sup>.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

---

<sup>2</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_**

**Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_**

**Vula \_\_\_\_\_**

## Shtojca 7/1

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

## Shtojca 8

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c. *Sigurimi i ofertes, (nëse është i zbatueshëm) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;*
- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

3.1.1 *Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.*

### 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

3.2.1 *Ne permbushje te kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar xhiro mesatare vjetore, gjatë tre viteve të fundit financiare, në një vlerë te pakten prej 4,000,000 (kater milion) lekë.*

*Operoret ekonomik qe kane aktivitet me pak se 3 (tre) vite, duhet te kene xhiro mesatare, ne vleren e kerkuar te pakten 4,000,000 (kater milion) lekë.*

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura ose kopje të certifikuara të bilanceve.

### 3.3 Kapaciteti teknik:

3.3.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit sherbime te ngjashme me objektin e prokurimit me nje vlere te pakten prej 4,000,000 (kater milion) leke.*

Lidhur me kete pike, kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Faturat duhet te jene te nenshkruara nga Shitesi dhe Bleresi.



3.3.2 *Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per realizimin dhe zbatimin e kontrates. Numri mesatar vjetor i punonjesve te siguruar per 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit, duhet te jete jo me pak se 30 (tridhjetë).*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: i) kontratat individuale te punes dhe ii) listpagesat E-Sig te punonjesve per periudhen e siperpermendur.

3.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij 1 (nje) specialist te certifikuar per sistemet PLC, per mirmbajtjen e sistemit kontroll monitorimit te godines.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: i) kontraten individuale te punes ii) certifikaten perkatese te specialistit te mesiperm si dhe iii) listpagesat E-Sig te pakten per periudhen 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

3.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij minimumi 2 (dy) specialist me certificate per mirembajtjen e sistemit ngrohje ftohje VRF.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: i) kontratat individuale te punes ii) certifikatat perkatese te specialistve te mesiperm si dhe iii) listpagesat E-Sig te pakten per periudhen 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

3.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij minimumi 1 (nje) specialist per sistemet BMS/SCADA.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: i) kontratat individuale te punes ii) certifikatat perkatese te specialistve te mesiperm si dhe iii) listpagesat E-Sig te pakten per periudhen 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

3.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete si drejtues teknik te pasqyruar ne Licencen e zbatimit te shoqerise 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1(nje) inxhinier mekanik, 1(nje) inxhinier elektrik.*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: i) kontratat individuale te punes ii) diplomat perkatese te inxhinierëve te mesiperm si dhe iii) listpagesat E-Sig te pakten per periudhen 6 muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

3.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij:*

- 1 (nje) Inxhinier hidroteknik,

- 1(nje) punonjes i kualifikuar si auditues energjitik ne ndertesa, ne perputhje me Ligjin Nr. 124/2015 „Per eficencen e energjise“, te pajisur me certifikaten perkatese si auditues energjitik.

- 1 (nje) punonjes te trajnuar per punime ne lartesi, te pajisur me certifikaten perkatese ne lidhje me frekuentimin e kurseve.

- 1 (nje) punonjes teknik ndertimi (minimalisht me arsim te mesem), te pajisur me deftese si teknik ne ndertim ose diplome ne fushen e ndertimit.

- 1 (nje) punonjes elektrikist.

- 1 (nje) punonje hidraulik.

- 1 (nje) punonjes mekanik.

- 1 (nje) punonjes bojaxhi.

- 1 (nje) punonjes hidroizolues.
- 1(nje) punonjes te kualifikuar si specialist/ekspert zjarrfikës, ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin, ne perputhje me piken 4, te nenit 49 te Ligjit Nr. 152/2015 „Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin“, te pajisur me certifikaten perkatese te mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: i) kontratat individuale te punes ii) diploma/certifikata perkatese per punonjesit e mesiperme, iii) listpagesat E-Sig ku te figurojne punonjesit e sipercituar, iv) kartelat e sigurimit teknik, sipas legjislacionit ne fuqi.

3.3.8 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve ose ekuivalent (të përkthyer dhe të noterizuara), te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, ne lidhje me objektin e prokurimit, si me poshte:*

- ISO 18001: ose 45001 për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë.
- ISO 14001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit.
- ISO 9001: për sistemin e menaxhimit të cilësisë.
- ISO 27001: për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

3.3.9 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me license profesionale leshuar nga organet perkatese, e cila te permbaje te pakten:*

- Kategoria NP-3, Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasade, **Klasifikimi A**
- Kategoria NS-2, Impiante hidro-sanitare dhe mirembajtja e tyre, **Klasifikimi A**
- Kategoria NS-4, Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese, **Klasifikimi A**
- Kategoria NS-12, Impiante teknologjik, termike dhe te kondicinimit, **Klasifikimi A**
- Kategoria NS-13, Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacionit, **Klasifikimi A**
- Kategoria NS-14, Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj, **Klasifikim A.**

#### **Shenim:**

- i. Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.**

3.3.12 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 7 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e*

*shoqerise, Ortakun/Ortakët e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise (perfshire te gjithe drejtuesit teknik qe jane ne licence).*

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Shenim: Në respekt të nenit 23 të LPP – së, në të gjithë rastet ne dokumentet e tenderit kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.**

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **Mirëmbajtja e Impianteve të Godinës së OST-së**

##### **I. Operatori i Sistemit të Transmetimit**

Operatori i sistemit të transmetimit (OST) është një kompani publike me aksione 100% të shtetit shqiptar. OST u krijua në 14.07.2004 si rezultat i ndarjes së kompanisë KESH, e cila kishte një organizim vertikal me funksion prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, në tre kompani të vecanta.

OST performon si operator i sistemit të transmetimit, operator i sistemit dispecer dhe operator tregu.

OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- Furnizimin e përdoruesve me energji për nën-stacionet e sistemit të shpërndarjes dhe klientët e lidhur drejtpërdrejt në rrjetin e transmetimit.
- Transmetimin e energjisë së prodhuar nga burime private.
- Gjithashtu garanton edhe shkëmbimet e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e tjera të rajonit.

##### **II. Informacion i përgjithshëm mbi Sistemet e Impianteve të Godinës**

Në godinën e re të OST-së të ndërtuar në komunën Kashar, në kilometrin e 9 të autostradës Tiranë – Durrës janë instaluar disa sisteme dhe impiante mekanike, elektrike dhe hidraulike. Duke parë kompleksitetin e impianteve në godinë është instaluar edhe një sistem BMS (Building Managing System) për kontrollin dhe monitorimin e të gjitha impianteve të instaluar në godinë. Godina është e konceptuar me ambiente të përbashkëta pune (open space) dhe zyrë të vecanta. Godina është e ndarë në dy seksione: OST dhe qendra dispecer. Gjithashtu në godinë ka edhe një ambient (bar & restorant), laboratorë, arkivë, magazinë, etj. Godina është me tre kate përkatesisht -1, 0 dhe

1. Sistemet e impianteve të instaluar në godinë janë të listuara këtu me poshtë:

- Sistemi i ventilimit dhe ajrit të kondicionuar (ngrohje dhe ftohje).
- Sistemi i furnizimit me ujë sanitar dhe impianti i trajtimit të ujit.
- Sistemi zjarrfikës.
- Sistemi i drenazhimit dhe shkarkimit të ujërave të bardha dhe të zeza dhe sistemi i vaditjes.
- Sistemi i mbyllur i kamerave dhe i dedektimit të hyrjes në godinë.
- Sistemi i transmetimit të dhenave dhe centrali telefonik i brendshëm
- Sistemi elektrik i ndricimit dhe i fuqisë.

- Sistemi i mbyllur i kamerave dhe sistemi i sigurise (dedektimit i hyrjes ne godine).
- Sistemi i ashensoreve
- Sistemi i dyerve automatike te godines

### **Sistemi i ventilimit dhe ajrit te kondicionuar ( ngrohje dhe ftohje).**

Sistemi ka si synim sigurimin e konfortit termik dhe cilesise se ajrit ne ambientet e zyrave, hapsirave te perbashketa te punes, magazinave, arkivave, laboratoreve dhe ambienteve sanitare. Sistemi i kondicionimit garanton vetem temperaturen dhe jo lageshtiren e ajrit, pervec ambienteve te vecanta ku kerkohet ftohje me delageshtim.

Ne sistemin e kondicionimit jane instaluar pajisjet e meposhtme:

- Sistemi i kondicionimit me VRF ( VARIABLE REFREGERENT FLOW ) per ambientet e zyrave dhe hapsirave te perbashketa te punes.
- Sistem ftohje me VRF ( VARIABLE REFREGERENT FLOW ) per abientet e serverave
- Njesit split unit INV per venderojen.
- Njesite trajtimit te ajerit AHU.
- Rimares energjie termike bashke me ventilatorin.
- Ventilatorete e ambjenteve sanitare.
- Rrjetin frigoriferik.
- Rrjetin e tubave te ajrit.

Kondicionimi (ngrohje-ftohje) i ambienteve te perbashketa te punes dhe zyrave kryhet me sistemin e kondicionimit VRF ( VARIABLE REFRIGERENT FLOW ) me ekspansion te drejteperdrejte. Sistemi i kondicionimit funksionon me pompa nxehtesie INVERTER me gaz 410A dhe paisje te brendeshme ne varesi te ambientit.

Perzgjedhja e ketyre pajisjeve eshte bere duke marre parasysh kerkesat dhe kohen e zbatimit te projektit. Karakteristikat e ketij sistemi jane listuar ketu me poshte:

- Kerkesat per hapësira te vogla te instalimit, duke i lene te gjitha hapësirat ne perdorim shfrytezuesit
- Rrezikshmeri te vogel per demtime te paisjeve elektrike dhe elektronike (paisje me kosto te larte) ne raste difekti ne rrjetin hidraulik te transmentimit.
- Fleksibilitet te sistemit ne lidhje me koordinimin me sistemet e tjera elektro – mekanike.
- Kohe te vogel instalimi.
- Kosto te ulet mirembajtje.
- Konsum te ulet energjie.
- Komunikim te thjeshte me sistemin e menaxhimit te godines.

### **Kondicionimi i ambienteve te perbashketa te punes dhe zyrave.**

Kondicionimi i godines eshte i ndare ne baze te seksioneve te godines dhe kateve te cdo seksioni. Ne taracen e cdo seksioni te godines jane instaluar pompat e nxehtesise INVERTER qe sherbejne per kondicionimin e ambienteve te seksionit. Keto pompa lidhen me njesite e brendshme nepermjet rrjetit frigoriferik. Per cdo kat te seksionit jane instaluar dy pompa nxehtesie.

Rrjeti frigoriferik eshte prej tubash bakri te termoizoluar te pershtatshem per instalime te sistemit te kondicionimit. Per instalimin e rrjetit frigoriferik jane perdorur aksesoret e nevojshem bashkues, degezues dhe brryla me dimensione sipas rrjetit. Instalimi i rrjetit frigoriferik eshte bere me stafa mbajtese per tubat e ngurte ndersa pjeset fleksibel jane te instaluara edhe direkt ne tavan.

Paisjet e brendshme jane te tipeve si me poshte:

- tavanore tip kasete me kater drejtime te fryrjes se ajrit.
- tip konsolle tek zyrat dhe tek salla e kontrollit
- tip kasete me dy drejtime te fryrjes se ajrit tek disa zyra ne katin nentoke.

Madhesite e pajisjeve te brendshme jane perzgjedhur ne varesi te humbjeve termike. Sasia e pajisjeve te brendshme per ambientet e perbashketa te punes dhe sellen e mbledhjeve eshte bere ne perputhje me kerkesat arkitektonike duke patur parasysh nje uniformitet ne shperndarjen e ajrit. Komandimi i njesive te brendshme realizohet ne menyre lokale nepermjet termostatit te ambientit por edhe ne menyre qendrore nepermjet BMS.

Per zyrat e mbyllura eshte instaluar nje termostat per cdo ambient ndersa per ambientet e perbashketa te punes dhe ne korridore eshte instaluar nje termostat ne piken me te larget nga pajisjet e brendshme.

### *Ambientet e Serverave dhe UPS*

Per keto ambiente eshte parashikuar qe te kryhet vetem ftohja.

Sic duket edhe nga projektet arkitektonike ambientet e serverave jane te ndara ne te dy seksionet e godines CNC dhe OST ne katin perdhe.

Per nevojat e ftohjes se pajisjeve elektronike te serverave SCADA dhe TLC dhe UPS ne taracen e seksionit CNC eshte instaluar pajisa e jashtme e kondicionimit me ekspansion te drejteperdrejte dhe gaz frigoriferik R410A. Kjo paisje lidhet me pajisjet e brendshme nepermjet rrjetit frigoriferik prej tubi bakri te pershtatshem per instalime kondicionimi.

Paisjet e brendshme qe jane instaluar ne keto ambiente jane tip tavanor (montim drejtperdrejte ne tavan).

Per nevojat e ftohjes se pajisjeve elektronike te serverave TELEMATJE dhe IT ne tarracen e seksionit OST eshte instaluar paisja e jashtme e kondicionimit me ekspansion te drejteperdrejte dhe gaz frigoriferik R410A. Kjo pajisje lidhet me paisjet e brendshme nepermjet rrjetit frigoriferik prej tubi bakri te pershtatshem per instalime kondicionimi.

Pajisjet e brendshme qe jane instaluar ne keto ambiente jane tip tavanor (montim drejteperdrejte ne tavan).

Komandimi i njesive behet lokal nepermjet termostatit te ambientit dhe qendror nepermjet sistemit te menaxhimit BMS.

### **Bari (ngrohje dhe ftohje)**

Per arsye kontrolli, madhesie si edhe mundesise se shfryrezimit ne te ardhmen nga nje person fizik ose juridik jashte OST, kondicionimi i ketij ambienti behet ne menyre te pavarur.

Kondicionimi i ambienteve te barit behet nepermjet nje pompe nxehtesie INVERTER R410A qe eshte montuar ne tarracen e godines nga ana e seksionit te OST. Nepermjet tubave frigoriferik prej bakri behet lidhja me pajisjet e brendshme.

Pajisjet e brendshme jane tip kasete me kater drejtime te fryrjes se ajrit per kondicionim te drejteperdrejte dhe kanalore per futjen dhe nxjerrjen e ajrit te fresket.

Komandimi i njesive te brendshme kryhet ne menyre lokale me termostat ambientit dhe qendror nepermjet BMS.

Kondicionimi ambjentit te gatimit behet nepermjet grilave tranzit ne dyert hyrese nga ambjenti i barit.

#### *WC*

#### **Ajri i kondicionuar.**

Ajri i kondicionuar ne ambientet sanitare behet nepermjet grilave tranzit ne hyrjen kryesore dhe hapsires boshe te cdo dere.

#### *Arkiva*

Ne keto ambiente jane instaluar sisteme kondicionimi. Ne keto ambjente eshte parashikuar sistemi i de-lageshtimit per te mbajtur nivelin e lageshtires relative ne intervalin 40-45%.

#### *Magazina dhe ambientet teknike*

Ne keto ambiente nuk eshte parashikuar kondicionimi.

#### *Vendroja*

Per nevojat termike te ambjentit te vendrojes eshte instaluar nje njesi INVERTER tip multisplit.

#### *Rrjeti Frigoriferik*

Rrjeti frigoriferik eshte ndertuar me tuba bakri ndersa gazi frigoriferik i perdorur eshte R410A. Tubat e bakrit jane pa tegel, te pershtatshem per sisteme kondicionimi me rezistence te mire karshi presionit te larte, me izolim termik ARMAFLEX dhe me spesor te pakten 9mm. Temperaturat e punes jane 120°C per linjat e gazit dhe 70°C per linjat e lengut.

Ne rrjetin frigoriferik per furnizimin e pajisjeve te brendeshme do te perdoren degezues prej bakri.

#### **Sensoret e instaluar dhe mbrojtjet e paisjeve.**

- Sensore per presionin e larte
- Sensore temperature per kompresorin
- Valvol sigurie
- Sensor temperature per ventilatoret

- Mbrojtja nga mbingarkesa.
- Mbrojtja nga mbitensioni do të realizohet me uljen e frekuences se inverterit ne 40Hz.

### **Funksioni “defrost”**

Ky funksion është bere i programuar, ku temperatura e nisjes se ketij funksioni do të ndryshoje ne varesi te temperatures se jashtme dhe vetem ne rastet kur qarku i kondesatorit është i ngrire.

### **Rrjeti i furnizimit me ajer**

#### **Tubacionet e furnizimit me ajer**

Rrjeti i furnizimit me ajer është llogaritur sipas medotes se renies se njejte te presionit ne tubacion dhe është ndertuar gjeometrikisht ne forme katrore prej llamarine celiku te zinkuar.

Spesori i llamarines ne varesi te dimensioneve te tubit është si me poshte:

- Per tub me brinjen e madhe - 300mm  $\delta=0.6\text{mm}$
- Per tub me brinjen e madhe - 750mm  $\delta=0.8\text{mm}$
- Per tub me brinjen e madhe - 1250mm  $\delta=1.0\text{mm}$
- Per tub me brinjen e madhe  $> 1250\text{mm}$   $\delta=1.25\text{mm}$

Lidhja e pjeseve te rrjetit deri ne madhesi 500mm është bere me shina ndersa per madhesi me te medha lidhja është bere me flanaxha.

Tubat fleksibel jane alumini me termoizolim per ajrin e trajtuar dhe alumini pa termoizolim per ventilim. Tubat me termoizolim jane prej dy shtresash alumini dhe ndermjet ketyre dy shtresave është vendosur temoizolimi me lesh xhami me trashesi 2.5cm.

Termoizolimi i tubave te ajrit te dergimit dhe rikthimit është realizuar me material izolues tip armaflex me ngjitje.

Ne te gjitha degezimet e tubit te dergimit dhe ne qafen e grilles nga ana e tubit te dergimit jane instaluar dampera volumi per rregullimin e sasise se ajrit sipas kerkesave te ambjenteve.

Keto dampera jane me flanaxha dhe jane instaluar ne rrjetin e tubit. Ato jane te ndertuara prej fletesh te rrotullueshme prej celiku te zinkuar. Nje doreze plastike është instaluar jashte tubit per rregullimin e volumit te ajrit.

Qafa metalike e lidhjes se tubit fleksibel te griles se dergimit do te sherbeje edhe si damper volumi tip “flutur” me doreze plastike.

#### **Damperat e zjarrit**

Ne kalimet e tubave te ajrit nga nje ambient zjarrdurues tek nje tjetër jane instaluar dampera zjarri. Keto jane tip perde prej materiali llamarine celiku e zinkuar dhe tip flanaxhe per montim. Perdja e damperit do te mbahet e hapur, aty është instaluar nje pllake bimetalike me qendrushmeri termike deri ne 72°C.



Grilat e ajrit janë të njëjta, si ato të dergimit edhe ato të rikthimit për arsye arkitektonike. Ato janë tip “me dy rreshta dhe damper” me dy madhësi duke ruajtur një standardizim të grilave për zyrat dhe ambienteve të përbashkëta të punës, ndërsa tek bari është instaluar i njëjti tip grille por me permasa më të mëdha. Ato janë metalike dhe në varesi të kërkesave arkitektonike do të mund të lyhen me bojë elektrostatische.

Në ambientet e katit nën tokë edhe në të gjitha pikat ku kërkohet hyrje ose nxjerrje ajri nga ambienti i jashtëm janë instaluar grila “Shiu”.

### **Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianti i trajtimit të ujit.**

Për furnizimin e godinës me ujë sanitar është ndërtuar një depozitë prej betoni me kapacitet  $60 \text{ m}^3$ , e cila mund të plotësojë nevojat e godinës për një periudhë dy javore.

Plotesimi i nevojave të godinës me ujë sanitar gjatë periudhës së shirave është menduar të bëhet me ujë të mbledhur në pusët e drenazhit. Për këto arsye në dy pusët e drenazhit nga ana lindore e godinës janë instaluar dy elektropompa. Këto elektropompa me anë të një rrjeti hidraulik të realizuar me tuba HDPE përdoren për mbushjen e depozitës së ujit sanitar. Funksionimi i tyre është automatik.

Gjatë sezonit të thatë sasia e ujit që gjendet në katër pusët e ndërtuara do të përdoren për vaditjen e pemëve dhe të barit. Në këtë periudhë godina do të furnizohet me ujë nga jashtë me anë të një tubacioni të dedikuar për këto qëllime.

Në ambientin mekanik të katit -1 është instaluar sistemi i klorifikimit dhe sistemi i filtrimit e zbutjes së ujit.

Sistemi i klorifikimit monitoron dhe dozon në mënyrë automatike hipoclorit në ujë të depozitës. Kjo kryhet nëpërmjet një pompe riqarkulluese. Nëpërmjet pompës riqarkulluese e cila punon me kronometër bëhet edhe ajrimi fizik i ujit të depozitës.

Një pompe shtytëse merr ujë nga depozita dhe uji pasi filtrohet dhe zbutet dërgohet në një depozitë  $6 \text{ m}^3$  (2 depozita metalike me kapacitet  $3 \text{ m}^3$  secila të lidhura në paralel). Sistemi i trajtimit të ujit përbëhet nga një shkëmbyes jonik, i cili rigjenerohet me kripe (NaCl) dhe punon në mënyrë automatike.

Duhet theksuar se uji është vetëm për përdorim sanitar, nuk është i pijshëm.

Depozita e ujit mbushet në mënyrë automatike. Ajo është e kontrolluar nga sensore niveli elektronike që komandojnë pompat e furnizimit. Gjithashtu për menjanimin e emergjencave në rast difekti të sistemit elektronik të nivelit të depozitës në tubin furnizues është instaluar një galexhant mekanik me sferë, i përshtatshëm për dimensionin e tubit.

Depozita e ujit do të lidhet me stacionin e pompimit me një rrjet hidraulik të pajisur me valvola dhe kontravalvola dhe filtra për një funksionim normal të sistemit.

Sistemi i pompimit është i përbërë prej dy pompash me karakteristika Q-h  $10 \text{ m}^3/\text{h}-50 \text{ m}$  secila, të lidhura në një kolektor të përbashkët. Komandimi kryhet nga kuadri elektrik që ushqehet nga inverteri, sensoret e nevojshëm për komandim dhe valvolat dhe kondravalvolat për izolimin e rrjetit.

Rrjeti kryesor furnizues është ndertuar prej tubi polypropilenium PPR. Rreti furnizues është instaluar në tavanin e cdo kati. Në degezimet e rrjetit dhe në pikat fundore për një selektivitet të rrjetit furnizues dhe izolim të seksioneve në rast avarie janë instaluar valvola izoluese.

Në ambientet e cdo grupi banjosh është instaluar kuadri hidraulik. Kuadri hidraulik është metalik dhe do të përmbajë seksionin e hyrjes së ujit të ftohtë, kolektorin modular të ujit të ftohtë, kolektorin modular të ujit të ngrohtë dhe të gjitha pjesët izoluese të rrjetit.

Në cdo grup banjosh në ambientin teknik është instaluar një ngrohës elektrik (boiler) për prodhimin e ujit të ngrohtë.

Rrjeti furnizues i pikave fundore është ndertuar prej tubi me shumë shtresa PEX-AL-PEX me izolim termik. Cdo linjë nga kolektori deri tek paisja do të ketë valvolë në fillim (kolektor) dhe në fund të linjës.

Për dimensionimin e rrjetit hidraulik janë marrë për bazë të dhënat e mëposhtme për cdo pajisje sanitare:

Lloji i pajisjes	Uji i ftohtë (l/s)	Uji i ngrohtë (l/s)	Presioni min (bar)
Lavaman	0,07	0,07	0,5
Lavapjate	0,15	0,15	0,5
Depozite shplarje	0.13	-	0.5
Cezem	0,15	-	0,5

Shpejtësia e rrjedhjes së ujit është si më poshtë:

Lloji i rrjetit	Shpejtësia (m/s)
Kryesor	1,5 – 1,8
Fundor	1,2

Kolektori kryesor është prej tubi të zinkuar pa tegele.

Kolektorët lokal janë ndertuar prej pjesësh modulare gize të montuara në kaseta metalike brenda murit. Në hyrje dhe në dalje të kolektoreve janë instaluar valvola izolimi.

Tubat e rrjetit kryesorë janë prej materiali polipropileni PPR. Rrjeti do të ndertohej me ngjitje. Të gjithë aksesoret e rrjetit janë nga i njëjti material PPR me ngjitje.

Rrjeti dytesor do të ndertohej nga tuba PEX-AL-PEX me izolim termik. Për këto rrjete nuk lejohen bashkimet ose ngjitjet. Aksesoret e rrjetit janë montuar me rakorderi të pershtatshme për këtë sistem me shtrengim.

Lidhja e paisjeve hidrosanitare është bërë me tuba fleksibel me diametër pak a shumë 10mm me rakorderi.

Tubat e rrjetit kryesor do të fiksohen në shtratin që do të varet nga tavani me prishionire cdo 1.5m dhe me fikues hidraulik me gomine.

Tubat e rrjetit dytesor janë instaluar në dysheme para shtresës perfundimtare.

### Valvolat izoluese

Cdo hyrje dhe dalje nga kolektori kryesor është e paisur me valvol izolimi të tipit sferë (ball valve). Në përgjithësi këto valvola janë të njëjta me materialin e linjes. Valvola izolimi janë të instaluar edhe në degezimet e rrjetit.

Minivalvola izolimi me sferë (ball valve) janë instaluar edhe në dalje të kolektoreve lokal dhe në pikat e lidhjes së pajisjeve hidrosanitare.

Gjatë periudhës së shërbimit kontratori duhet të kryejë kontrolle periodike në të gjitha pajisjet e sistemit, në mënyrë që ato të funksionojnë në mënyrë korrekte.

Këto shërbime që duhet të kryejë kontratori jepen në tabelën e mëposhtme, në të cilën rekomandohet edhe frekuenca me të cilën duhet të kryhen këto shërbime.

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Frekuenca (here vit)
1	Kontroll vizual dhe riparim i lavamanëve të godinës	cope	25	12
2	Kontroll vizual i WC të godinës	cope	31	12
3	Kontroll vizual dhe riparim i mishelatoreve të ujit të godinës	cope	35	12
4	Kontroll vizual dhe riparim i kuadrove hidraulike të godinës	cope	20	12
5	Kontroll vizual dhe riparim i pishuareve të godinës	cope	10	12
6	Kontroll vizual i piletave të shkarkimit të godinës	cope	54	12

### Sistemi i drenazhimit dhe shkarkimit të ujrave të bardha dhe të zeza.

Në këtë sistem përfshihen rrjetet e tubacioneve dhe pajisjet e mëposhtme:

- Rrjeti i brendshëm i godinës për shkarkimin e ujrave të zeza dhe rrjeti i ventilimit.
- Instalimi i pajisjeve hidrosanitare.
- Rrjeti i shkarkimit të ujrave të shiut.

### Sistemi i shkarkimit

Projektimi i rrjetit të shkarkimeve të ujrave të bardha me gravitet është bërë në bazë të standardit EN 12056-3, ku janë marrë të dhënat e mëposhtme:

- Sasia vjetore e reshjeve – 0.030 l/m<sup>2</sup>

- Koeficienti i rrjedhshmerise 0.8

### **Shkarkimet e ujrave te zeza**

Per dimensionimin e rrjetit te ujrave te zeza eshte perdorur program i llogaritjeve 4M/CALC. Largimi i ujrave te zeza eshte me gravitet per katet e nivelit zero dhe +1 ndersa per katin nen toke largimi i ujrave te zeza kryhet me pompe.

Ne katet 0 dhe +1 shkarkimet ecin ne menyre horizontale me pas vertikalisht ato arrijne deri tek tavani i katit -1, dhe perseri me rrjet horizontal ato lidhen me rrjetin e jashtem te shkarkimeve ne pjesen e pasme te godines.

Per shkak te pengesave konstruktive qe hasen ne grupin e banjove te kuzhines ne nivelin zero cdo grup do te zbrese individualisht ne nivelin -1. Ne tavanin e -1 keto zbritje bashkohen ndermjet tyre dhe pastaj do te bashkohen me pjesen tjetere te rrjetit per te vazhduar rrugen drejt rrjetit te jashtem. Pjerresia e tubave horizontal eshte  $j = 1.5\%$ . Ne cdo ndryshim drejtimi te ketij rrjeti jane instaluar tapa pastrimi.

Ne katin -1 ne koridorin teknik dhe mbrapa grupeve te banjove te cdo seksioni eshte instaluar nga nje depozite per ujerat e zeza te ketyre grupeve. Cdo depozite eshte e pajisur me cifte pompash elektrike.

Sistemi i pompit eshte ne gjendje te punoje ne dy nivele si me poshte:

- Niveli i poshtem: nje pompe ne pune
- Niveli i siperm: te dy pompat ne pune.

### **Paisjet e WC dhe Pishuaret**

Paisjet hisrosanitare wc dhe pishuaret lidhen ne kolektorin horizontal te seksionit te godines per cdo kat. Per lidhjen e tyre me kolektorin horizontal perdoren aksesore rrjeti me kende te hapura. Jane menjanuar kthesat dhe zbritjet me kende te plota.

### **Lavamane dhe lavapjata**

Paisjet hidrosanitare lavane dhe lavapjata lidhen me rrjetin e shkarkimit nepermjet nje pilete dyshemeje tip kolektor. Keto paisje nepermjet tubave plastik me diameter te pershtatshem shkarkojne ne pileten e dyshemese dhe piletat shkarkojne ne kolektorin horizontal te seksionit te cdo kati.

### **Ventilimi i rrjetit te shkarkimit te ujrave te zeza**

Ventilimi i rrjetit eshte bere me vazhdimin e kolonave vertikale deri tek taraca e godines me te njejtin dimension tubi. Ne krah te ketij tubi eshte instaluar nje tub i vecante me te njejtin dimension

i cili shërben vetëm për ventilimin e rrjetit. Keta dy tuba bashkohen me pjerresi të kundert në tavanin e katit +1 dhe në tavanin e katit -1.

Ventilimi i pajisjeve të largëta është bërë me tub plastik me diametër të njëjtit me kollonën vertikale me pjerresi të kundert. Tubi i ventilimit të pajisjeve të largëta lidhet me kollonën vertikale të ajrimit. Gjithashtu nga gropat mbledhëse të katit nën tokë OST dhe CNC është instaluar një tub që do të lidhet me kollonën e ajrimit.

### **Shkarkimi i ujrave të shiut**

Shkarkimet e ujrave të shiut janë kryer me rrjedhje të lirë me gravitet. Në çdo kollonë të godinës janë instaluar tubat e shkarkimit me seksion katror. Në nivelin zero këto shkarkime do të shkarkojnë në kunetat e rruges.

Për mbrojtjen e sifonave të taracës nga papasterite e mundeshme janë instaluar rrjeta metalike mbrojtëse.

Në nivelin -1 në fund të rampës nga të dyja seksionet do të ndërtohet një kanal për mbledhjen e ujrave të rampës. Këto ujëra do të mbledhen në një pusëtë ku është instaluar një çift pompash.

### **Shkarkimi i ujrave nentokesore**

Për mbajtjen e nivelit të ujrave nentokesor në nivelin poshtë nivelit të platesë janë instaluar kater pusëta të paisura secila me një çift pompash elektrike. Komandimi i pompave është bërë me galexhantë tip dardhe.

Sistemi i pompimit është në gjendje të punojë në dy nivele si më poshtë:

- Niveli i poshtëm: një pompe në punë
- Niveli i sipërm: të dy pompat në punë.

### **Sistemi antizjarrit (zjarrfikës).**

Ky sistem është i përbërë si më poshtë:

- Depozita e ujit.
- Sistemi i pompimit.
- Rrjeti i përhershëm i hidranteve të ujit.
- Aksesoret për mbrojtjen kundër zjarrit.
- Fikesat portative të zjarrit.

### **Rrjeti hidraulik i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit.**

Në godinë është parashikuar instalimi i rrjetit të përhershëm hidraulik dhe hidrantet e ujit. Karakteristikat e rrjetit janë si më poshtë:

- Prurja e cdo hidranti është 120litra/min
- Sasia e hidranteve që funksionojnë njekohesisht 4
- Presioni i punës 2 bar
- Kohezgjatja e funksionimit në rast nevojë 120min.

Në godinë janë instaluar një numër i pershtatshëm hidrantesh dhe në pozicione të pershtatshme në mënyrë që hidrante me tub fleksibel 20m dhe rreze hedhjeje 10m të mbulojnë të gjithë sipërfaqet e godinës. Rrjeti hidraulik në përgjithësi është i dukshëm.

Dimensionimi i rrjetit me programin llogarites 4M/CALC.

Dimensionimi i rrjetit të hidranteve është:

1 HID	2 ~3 HID	4 ~6 HID	7~10 HID	17 ~25 HID.
2''	2 <sup>1/2</sup> ''	3 ''	4 ''	5 ''

Për furnizimin me ujë nga motopompa e PMNZSH (Policia e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe e Shpetimit) në pjesën e përparme nga ana e seksionit CNC është instaluar një çift grykash DN100. Një numër i caktuar fikësash portative (tip me pluhur 6kg) janë instaluar në pozicione të tilla që largësia nga cdo pikë e godinës deri tek zjarrfikësi portativ të mos jetë më e madhe se 15m dhe largësia ndërmjet tyre të jetë 25m.

Në hyrje të godinës në katin zero është instaluar një zjarrefikës portativ 25kg.

Në të gjithë ambientet mekanike është instaluar një fikës portativ ( tip me pluhur 6kg) dhe një fikës portativ ( tip me CO2 6kg).

Në ambientet e serverave janë instaluar dy fikës ( tip me CO2 6kg).

Për garantimin e funksionimit të sistemit zjarrfikës për një kohë 120 min duke funksionuar njekohesisht katër hidrante me prurje 120 litra/min, në katin -1 në ambientin mekanik është instaluar një depozitë metalike me vëllim 60 m<sup>3</sup>.

Depozita është e paisur me rrjetin e mbushjes dhe rrjetin e furnizimit të hidranteve.

Mbushja e depozitës kryhet në mënyrë automatike. Depozita është e paisur me:

- Dritare kontrolli në anën e sipërme 80x80cm
- Tubin e furnizimit me elektrovalvol dhe galexhant mekanik
- Tubi i ajrimit
- Tubi i rikthimit të testimit
- Tubi i mbimbushjes në nivelin e sipërm të depozitës
- Tubi i zbrazjes së depozitës.

Në godinë është instaluar grupi i pompave zjarrfikëse i përbërë nga:

- Elektropompa primare
  - ✓ Pompe centrifugale
  - ✓ Motor elektrik

- Elektropompa reserve
  - ✓ Pompe centrifugale
  - ✓ Motor elektrik
- Elektropompa jockey (per mbajtjen ne presion te rrjetit zjarrfikes).
  - ✓ Pompe centrifugale
  - ✓ Motor elektrik
- Depozite me membrane
- Kuadri i fuqise dhe i automatikes.  
Kuadri elektrik do te kete te gjitha pajisjet e nevojshme dhe eshte i montuar ne fabrike.
- Sensoret e komandimit dhe paisjet e izolimit.  
Minimumi i sensoreve qe do te monitoroje sistemin e pompimit dhe paisjeve te izolimit jane:
  - ✓ Tre sensore diferencial presioni per kontrollin dhe funksionimin e sistemit te pompimit
  - ✓ Tre mates presioni me valvol izolimi
  - ✓ Tre kundralvola dhe tre valvola nga pompa ne drejtim te kolektorit te dergimit
  - ✓ Tre valvola nga kolektori i thithjes ne drejtim te pompave

Tubat e rrjetit te sistemit zjarrfikes jane prej çeliku te zinkuar.

Tubat jane me tegel sipas DIN 2440 (Medium-weight threaded steel tubes) dhe do te lidhen me fileto. Rrjeti eshte i ndertuar per te funksionuar ne presion nominal 16 bar.

Rrjeti zjarrfikes i eshte nenshtuar testit hidraulik me presion 18 bar per 24 ore.

#### **Metoda dhe aksesoret e fiksimit te tubave.**

Instalimi i tubave te sistemit te zjarrit eshte bere sipas EN 10779 kapitulli 7.2. Sistemi jane fiksuar me aksesoret kollaro tip “dardhe” me prixhionier te montuar ne strukturen e betonit te tavanit.

Ne tabelen e meposhtme tregohet seksioni minimal i aksesorit te mbeshtetjes, trashesia e kollares dhe prixhionieri.

DN	Seksioni minimal neto i mbeshtetjes mm <sup>2</sup>	Spessori minimal i mbeshtetjes mm	Dimensioni i prixhionierit mm
Deri ne 50	15	2.5	M8
nga DN 50 deri ne DN 100	25	2.5	M10
nga DN 100 deri ne DN 150	35	2.5	M12
nga DN 150 deri ne DN 200	65	2.5	M16
nga DN 200 deri ne DN 250	75	2.5	M20
Per mbeshtetes me kollaro : 1.5mm			

Fikesi portativ eshte bombule prej metali cilesie EDDQ me presion prove 35 bar. Bombulat kane vetem nje hapje me buze te filetuesheme ne te cilen lidhet valvola e leshimit, doreza dhe manometri

i kontrollit të presionit të brendshëm, me simbole dhe ngjyra për kontroll të menjehershëm. Fikesat pluhur janë të pershtatshme për fikjen e zjareve A.B.C. me tregimin e pershtatshëm.

### **Fikes portative CO2**

Fikesi portativ i dioksidit të karbonit është në përputhje me kërkesat NHS 31-1972, 32-1972, 33-1972.

Përveç kësaj fikesat portative CO2 kanë:

- ✓ Valvol leshimi
- ✓ Doreze
- ✓ Sistemin e varjes
- ✓ Kollare për varje

Te gjithë fikesat janë të testuar sipas NHS dhe janë të pajisura me tabelen ku janë të shkruajtura karakteristikat dhe metoda e përdorimit.

### **Sistemi i vëzhgimit dhe sinjalizimit të zjarrit**

Në godinë është parashikuar instalimi i sistemit të vëzhgimit dhe sinjalizimit të zjarrit në të gjitha ambientet e godinës siç tregohet edhe në vizatimet përkatëse. Për këtë është instaluar kuadri i vëzhgimit i adresueshëm me katër qarqe të mbyllura vëzhgimi (një qark i mbyllur për kat). Vëzhgimi i vatrave të zjarrit realizohet me instalimin e sensoreve të tymit.

### **Organizimi i sistemit**

Sistemi është i përbërë nga:

Kuadri i vëzhgimit dhe lajmerimit të zjarrit që do të mbledhë informacionin nga pajisjet periferike (sensore, butona, module monitorimi etj).

Sensore termike lineare të paadresueshëm.

Sensore të adresueshëm tymi të cilët lidhen në qarkun e mbyllur dhe do të instalohen në ambiente të ndryshme siç tregohen në vizatim.

Lajmerues të adresueshëm të cilët lidhen në qarkun e mbyllur dhe do të instalohen kryesisht në dalje siç tregohen në vizatime.

Njesite e lajmerimit optiko-akustik që do të shoqërojnë dhe do të komandohen nga butonat përkatëse dhe ushqim nga kuadri i sinjalizimit të zjarrit.

Kablloimet e nevojshëm që garantojnë transmetimin e sinjaleve impulsive nga njesite periferike në drejtim të kuadrit të sinjalizimit të zjarrit.

Kuadri i sinjalizimit të zjarrit bashkë me sistemin e ushqimit rezervë (baterite) është instaluar në katin përde tek zyra e sigurisë seksioni OST. Kuadri i sinjalizimit të zjarrit është i adresueshëm me tre zona (qark i mbyllur), një zonë për çdo kat.

Në rastin e një vatre zjarri ajo vëzhgohet nga njesia periferike e vëzhgimit të zjarrit dhe tregimet e mëposhtme bëhen menjëherë në kuader:

- Një tregues optik alarmi ndizet dhe fiket në kuader
- Një buzzer lokal në kuader do të sinjalizojë gjendjen e alarmit duke mos lejuar procedurën “silence”
- Ekranin e kuadrit tregon të gjidha të dhënat për alarmin dhe ambientin ku ka ndodhur.



- Mesazhet e ndryshimit të gjendjes tregohen në ekran ose printohen.

Nga ana tjetër kuadri në mënyrë të menjehershëm fillon procedurat e aktivizimit të sistemeve të lajmerimit optiko – akustik.

Në rast të një gjendje “difekt” në paisjet periferike ose në rrjetin e transmetimit (zone) kuadri ka tregimet e mëposhteme:

- Sinjalizimi optik i gjendjes “fault” aktivizohet
- Sinjalizimi akustik (buzzer) i ndryshëm nga sinjali akustik i gjendjes “alarm” me mundësinë e procedurës “silence” aktivizohet
- tregimin e tipit të difektit në kuadër.

Kuadri është i pajisur me dalje rele për sinjalizimin dhe aktivizimin e sistemit të lajmerimit publik dhe aktivizimin e paisjes telefonike për komunikim me numra të jashtëm dhe policinë e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga zjarri.

Programimi i mënyrës së lajmerimit të zjarrit bëhet në bashkëpunim me përdoruesin e godinës.

Në ambientet elektrike në të dy katet të sipërme ku do të kemi instalimin e kanalines metalike në dyshemene e ngritur do instalohet sensori optik. Për monitorimin e këtij sensori dhe integrimin e tyre në kuadrin e vëzhgimit dhe lajmerimit të zjarrit do të instalohen në qarkun e mbyllur tavanor. Për instalimin e sensoreve të zjarrit janë marrë për bazë funksionimi i tyre dhe pastaj kërkesat arkitektonike. Sensoret e instaluar janë :

- Sensor optik tymi
- Sensor termik
- Sensor termike lineare.

### **Sensoret optike të tymit**

Sensoret optike do të jenë të adresueshëm dhe janë instaluar poshtë tavanit të varur në të gjithë godinën me përjashtim të ambienteve të barit.

Sensoret optike të tymit kanë një zonë mbulimi 50-80m<sup>2</sup>. Largesia ndërmjet dy sensoreve është jo më e madhe se 10 m ndërsa largësia nga muret dhe pengesat vertikale jo më afër se 3.5m. Sensoret instalohen në një largësi jo më të vogël se 1m nga të gjitha paisjet dhe aparatat e fryrjes së ajrit. Sensoret e zjarrit janë me module izolimi të inkorporuar për të dhënë mundësinë e leximit të dyanshëm të kuadrit në rastin e difektit kabllor.

### **Sensoret termike**

Sensoret termike janë instaluar në ambientin e barit poshtë tavanit të varur.

Sensoret termike kanë një zonë mbulimi 100m<sup>2</sup>. Largesia ndërmjet dy sensoreve është jo më e madhe se 13m ndërsa largësia nga muret dhe pengesat vertikale jo më afër se 6m. Sensoret instalohen në një largësi jo më të vogël se 1m nga të gjitha paisjet dhe aparatat e fryrjes së ajrit. Sinjalizimi manual i zjarrit do të instalohet në të gjithë godinën.

Për sinjalizimin manual të zjarrit në daljet e emergjencës të çdo kati janë instaluar sinjalizues manual (buton) me xham në mënyrë që largësia maksimale për të aritur tek pulsanti gjatë daljes së emergjencës të mos jete më e madhe se 30m. Me shtypjen e butonit, bëhet në mënyrë automatike

nga kuadri pozicionimi i sakte i ambientit nga ka ardhur sinjalizimi. Butonat manuale te sinjalizimit te zjarrit jane te adresueshem dhe lidhen ne qark te mbyllur.

Sinjalizuesi optiko akustik eshte ne te njejtin pozicion dhe komandohet prej sinjalizuesit manual (buton). Ai furnizohet nga kuadri i sinjalizimit te zjarrit.

### **Rrjeti kabllor**

Rrjeti kabllor horizontal i sistemit te sinjalizimit te zjarrit eshte ndertuar prej kablli sinjali 2x0.8mm<sup>2</sup> i cili do te instalohet ne tuba plastike rigide brenda tavanit te varur, ndersa rrjeti vertikal do te instalohet ne kanalinen e rymave te dobeta te instaluara ne menyre vertikale ne ambjetet elektrike.

Duhet te vendoset centrali qendor i monitorimit dhe dedektimit te tymit ( perpara se te vendoset dhe konfigurohet duhet te realizohet tarimi i te gjitha sensoreve te vendosur ne godine ( 400 sensore ).

### **Sistemi elektrik i ndricimit dhe i fuqise.**

Ne sistemin e elektrik perfshihen nensistemet dhe paisjet e meposhteme:

- Furnizimi me energji elektrike i godines, me tension te mesem 20 kV nga nenstacioni “Tirana 2”.
- Celat e komandimit te linjes dhe transformatorit per tensionin 20 kV
- Transformatoret e fuqise 20/0.4 kV
- Kuadri kryesor i tensionit te ulet
- Gjeneratori i emergjences
- Sistemi i UPS-ve
- Rrjeti shperndares dhe furnizues me tension te ulet
- Kuadrot lokal te tensionit te ulet
- Nricimi i brendshem
- Ndricimi i jashtem.

### **Furnizimi me energji i godines**

Furnizimi i godines eshte bere nga nenstacioni “Tirana 2” me dy feedera 20kV. Vlerat elektrike te rrjeteve jane si meposhte:

#### **Tensioni i mesem**

- Tensioni nominal – 20kV
- Tensioni maksimal – 24kV
- Numri i fazave - 3
- Frekuenca – 50HZ

#### **Tensioni i ulet**

- Tensioni nominal – 0.4/0.23kV
- Numri i fazave - 3+N
- Frekuenca – 50Hz

Kabllo e furnizimit me energji

Furnizimi i godines eshte bere nga nenstacioni “Tirana 2” nga ana e tensionit te mesem 20kV ne celat A4 she B4.

Kablli i linjes eshte Alumini 3x1x185/25mm<sup>2</sup> me izolim XLPE/PVC dhe me tension nominal 12/20kV.

Ne pjesen e linjes nga nenstacioni deri tek rrethimi i nenstacionit kablli eshte shtrire ne kanaleten egzistuese te nenstacionit. Per hyrjen e kabllove ne godinen e nenstacionit jane perdorur hyrjet egzistuese te nenstacionit.

Kalimi i kanalit i cili ndodhet ne rrethimin e nenstacionit kryhet me ndihmen e tubave metalike.

Ne pjesen e linjes nga rrethimi i nenstacionit “Tirana 2” deri tek rrethimi i godines kabllo e linjave jane instaluar ne tuba elektrike HDPE. Ne distance cdo 24m jane ndertuar puseta kalimtare per shtrimin e kabllit. Tubat jane te vendosur ne kanal.

Profili i kanalit eshte:

- Gjeresia 60cm
- Thellesia e kanalit 110cm

Ne pjesen e brendeshme te oborit te godines kablli eshte instaluar ne tuba HDPE nga rrethimi deri ne hyrje te godines ne interkapet.

Ne inerkapet deri tek celat e tensionit te mesem kabllo jane instaluar ne pasarella metalike.

Per menjanimin e kalimit te ujit ne godine nga pika e hyrjes se kabllove jane mare masa hidroizoluese.

### **Panelet e tensionit te mesem**

Celat e tensionit te mesem jane instaluar ne katin nentoke. Ne dyshemene e ambientit te tensionit te mesem jane ndertuar kanale elektrike te cilat jane mbuluar me kapak metalik duke lejuar hyrjen e kabllove te tensionit te mesem nga ana e poshteme e celes.

Sic u permend edhe me siper, godina eshte furnizuar me dy fidera 20kV. Keto dy fidera jane lidhur celat hyrese me aksesore te pershtatshem (koka kablli te brendeshme) ,si per tensionin ashtu edhe per dimensionin e kabllit.

Ne katin nentoke ne ambientin elektrik te tensionit te mesem jane instaluar dy grupe celash ( per cdo fider ) qe funksionojne ne menyre te pavarur nga njera-tjetra.

Secili grup eshte i perbere nga:

- Cela e hyrjes e pajisur me ndares ngarkese SF6 me tre pozicione.
- Cela mbrojtese e transformatorit me:
  - ✓ Celes SF6
  - ✓ Ndares ngarkese me tre pozicione
  - ✓ Rele kontrolli dhe komandimi

Ne gjendje normale të dyja grupet e cleave janë të kycura (nën tension)

### **Transformatoret**

Ne godine janë instaluar dy transformatore të thate 800 kVA. Këta transformatore janë rezerve të njëri tjetrit dhe asnjë herë nuk do të punojnë në paralel. Secili transformator furnizohet nga cila mbrojtëse e fiderit përkates me kabell 3x1x185/16mm<sup>2</sup> me izolim XLPE/PVC dhe me tension nominal 12/20kV që do të lidhet me aksesore të përshtashëm për tensionin dhe dimensionin e kabllit (koka kablli). Kablli do të instalohet në kanaline metalike.

Për zvogelimin e humbjeve në regjimin pa ngarkesë janë instaluar blloqe kondensatorësh të përhershëm.

Transformatoret janë të pajisur me sonda të temperaturës tip Pt100. Në kuadrin kryesor të tensionit të ulët do të instalohet dy pajisje elektronike për monitorimin e sondave të temperaturës. Në varesi të temperaturës së sondave pajisja elektronike kryen:

- Fillimin e ventilimit të sforcuar të ambientit (FAN)
- Sinjalizim për temperaturë të lartë në transformator (ALARM 1).
- Çkycjen e automatit të tensionit të ulët në rast se temperatura qoftë edhe e njëres prej pështjellave të jetë më e madhe se e lejuara (TRIP)

Për ajrimin e ambientit të transformatoreve është instaluar një ventilator centrifugal. Për të patur një cikël të mirë të qarkullimit të ajrit dera e transformatorit është me grila ajrimi në mënyrë të tillë që ajri nga ambienti i brendshëm nepermjet grilave të derës të qarkullojë nga poshtë lartë duke krijuar një ftohje të përshtatshme të transformatoreve.

### **Kuadri kryesor i tensionit të ulët.**

Kuadri kryesor i tensionit të ulët është instaluar në katin nëntokë në ambientin elektrik pranë ambientit të transformatoreve. Kuadri kryesor është i tipit modular me instalim në tokë dhe i hapur. Secili modul do të jetë i përmasave të standardizuara 800x800x2000mm. Lidhja e transformatoreve me kuadrin kryesor është bërë me kabllo PVC/PVC 0,6/1kV. Kabllot janë instaluar në kanaline metalike të montuar në tavan.

Nga ana elektrike rrjeti Transformator – Kuader Kryesor Tensionit të Ulet është i tipit TN-S.

Nga ana e burimeve furnizuese KKTU është i ndarë në dy seksione:

- Seksioni “normal”, furnizim vetëm nga linjat e nënstacionit.
- Seksioni i “emergjencës”, furnizim nga transformatoret dhe në rast avarie të të dy linjave nga nënstacioni, si burim energjie për këtë seksion është gjeneratori i emergjencës.

Kompozimi dhe konstruksioni i KKTU është bërë në varesi të burimeve të energjisë elektrike dhe konsumatoreve që do të furnizohen nga ky kuader. Duke u nisur nga këto të dhëna kuadri do të kompozohet si mëposhtë:

- **Seksioni normal**
  - ✓ Dy automatet në karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 2500A 4P, të motorizuar, izolim (me zhvendosje mekanike) nga zbarat e tensionit dhe heqje

totale nga kuadri ne rast nevojë (withdrawable) per furnizimin nga transformatoret. Keta automate jane te paisur me te gjithë aksesoret e nevojshem per realizimin e funksioneve te mesiperme si dhe instalimin e multimetrave pas cdo automati. Te dy automatet jane me bllokim mekanik “interlock” ne te dyja funksionet automatik dhe manual.

- ✓ Blloku i kondesatoreve per permiresimin automatik te cosφ. Blloku i kondesatoreve eshte me 10 shkalle me 5kVAr secili bllok. Komandimi do te kryhet ne menyre automatike
- ✓ Dy automatet ne karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) per furnizimin e kuadrove te kondicionimit.
- ✓ Dy automatet ne karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 800A 4P, te motorizuar, izolim (me zhvendosje mekanike) nga zbarat e tensionit dhe heqje totale nga kuadri ne rast nevojë (withdrawable) per furnizimin e seksionit te “emergjences”. Keta automate jane te paisur me te gjithë aksesoret e nevojshem per realizimin e funksioneve te mesiperme si dhe instalimin e multimetrave pas cdo automati. Te dy automatet jane me bllokim mekanik “interlock” ne te dyja funksionet automatik dhe manual.

### **Seksioni i emergjences**

- ✓ Automatet me karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) te dimezoneve te ndrysheme 4P tip “fix” per furnizimin e konsumatoreve te ndryshem.
- ✓ Kater automatet ne karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 200A 4P tip “fix” per furnizimin e dy UPS 120kVA.
- ✓ Kater automatet ne karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 200A 4P tip “fix” per furnizimin e dy UPS 20kVA.

### **Gjeneratori i emergjences**

Per mosnderprerje te funksionimit te godines ne rast avarie te dy fiderave furnizues nga nenstacioni do te instalohet nje gjenerator emergjence. Ne baze te llogaritjeve te kryera nevojat e godines ne kete rast kerkojne nje gjenerator me fuqi LTP 440 kVA qe perdoret si burim i dyte energjie per furnizimin e seksionit te “emergjences”. Ai eshte instaluar jashte godines nga ana jugeperendimore ne nje bazament betoni te niveluar. Gjeneratori eshte i tipit te mbyllur.

Per funksionim te gjeneratorit per 24ore eshte inkorporuar nje depozite nafte.

Per hyrjen ne godine te kablllove furnizues nga gjeneratori eshte ndjekur e njejta metodike si edhe per hyrjen e kablllove te tensionit te mesem. Nga ana e gjeneratorit dhe nga ana e godines ne piken e hyrjes jane ndertuar dy puseta. Keto dy puseta jane lidhur me tuba metalike Φ200 ne te cilat do te futet kablli furnizues tip PVC/PVC 0,6/1kV. Nga hyrja deri tek kuadri kryesor i tensionit te ulet kabllot jane te montuara ne kanaline metalike.

### **UPS**

Per furnizimin e paisjeve te vecanta elektronike, te vendeve te punes dhe paisjeve qe nuk lejohet nderprerja e menjehershme e energjise (sistemet e sigurise) ne godine jane instaluar paisjet e furnizimit pa nderprerje te energjise UPS, burimi i energjise te “privilegjuar”. Burimi i “privilegjuar” do te furnizoje paisjet e siperpermendura ne intervalin kohor nga moment i nderprerjes se energjise deri ne ndezjen e gjeneratorit dhe ne rast avarie te gjeneratorit. Per nevojat e godines do te instalohen dy UPS 120kVA secili, te cilet jane rezerve e njeri - tjetrit. Te dy UPS lidhen me nje grup te perbashket baterish qe do te garantojne nje kohezgjatje furnizimi 60min.

Te dy UPS jane te montuar ne katin nentoke tek ambienti i “UPS”. Per nevojat ftohese te ambientit dhe per nje funksionim normal te paisjeve eshte instaluar nje sistem kondicionimi.

Per pajisjet elektronike te sigurise se larte, si serverat e sistemit SCADA, tlc, telemetering dhe IT, qe kerkojne nje furnizim te dyfishte eshte instaluar nje UPS i trete i cili do te furnizoje vetem keto paisje dhe sherben si burim energjie “sigurie”. UPS i burimit te “sigurise” eshte 20kVA me nje kohezgjatje 60min. Ai eshte instaluar ne katin nentoke, ne te njejtin ambient me dy UPS-te e tjera. Secili UPS furnizohet me dy linja nga seksioni i gjeneratorit.

Per nevojat e shperndarjes se fuqise te UPS-ve ne ambientet e UPS-ve eshte instaluar nje kuader elektrik me dy seksione:

- Kuadri i privilegjuar UPS 1ose UPS 2
- Kuadri i serverave.

### **Rrjeti i shperndarjes se tensionit te ulet.**

Sic u pershkrua edhe me siper ne godine jane instaluar:

- Rrjeti normal i furnizimit (furnizim nga fiderat e nenstacionit)
- Rrjeti i emergjences (furnizim nga gjeneratori ne rast difekti te dy fiderave te nenstacionit)
- Rrjeti privilegjuar (furnizimi nga UPS ne intervalin e kohes qe nevojitet per ndezjen e gjeneratorit ose ne rast avarie te dy fiderave te nenstacionit dhe te gjeneratorit)
- Rrjeti i sigurise (furnizimi nga UPS per serverat ne rast avarie te fiderave te nenstacionit, te gjeneratorit dhe pas nderprerjes se energjise nga rreti i privilegjuar).

Rrjeti i shperndarjes eshte ndertuar me kabell tensioni te ulet me izolacion dhe veshje PVC/PVC me izolim 0.6/1 kV. Keto kablllo jane instaluar ne kanalina metalike kryesisht ne rrjetin horizontal dhe ne shkalle metalike ne rrjetin vertikal.

### **Kanalinat dhe shkallet metalike.**

Kanalinat metalike sherbejne kryesisht per rrjetin horizontal te shperndarjes se tensionit te ulet. Ato jane te tipit te brimezuara te zinkuara ose tip rrjete. Per ndertimin e rrjetit te kanalinate jane perdorur aksesore te kompanise prodhuese. Rrjeti i kanalinate eshte dimensionuar ne varesi te kablllove qe do te instalohen ne te.

Kanalinat nisin nga kuadri kryesor i tensionit te ulet hyjne ne koridorin teknik te katit nen toke ku degezohen. Nje dege e kanalinate drejtohet ne drejtim te ambienteve teknike, pompat e zjarrit, ndersa dega tjeter vazhdon ne drejtim te laboreve te OST, duke lene degezimet per ngjitjet vertikale ne ambientet elektrike.

Instalimi i kanalrave është bërë me prishionier të fiksuar në tavan dhe me profile metalike mbështetës. Në kalimet e ambienteve zjarreduruese kalimet e kanalrave janë mbyllur me materiale zjarreduruese.

Shkallet metalike do të instalohen në rrjetin verikal. Kryesisht ky rrjet ndodhet në ambientet elektrike. Montimi i shkallës është bërë me profile “C” hekuri që do të shërbejnë edhe si distancator.

#### **Kabllo të tensionit të ulët.**

Kabllo të sistemit të shpërndarjes janë kabllo me izolim dhe veshje PVC, me tension izolimi 0.6/1kV. Kabllo do të instalohen në kanalrat horizontale dhe shkallet vertikale. Ato janë të etiketuara në fillim (kuadrin kryesor) dhe në fund të gjatësisë (kuadri lokal).

Për dimensionimin e madhësisë së kabllove janë marrë të dhënat e mëposhtme:

- Temperatura e punës 35°C
- Menyra e instalimit “F ose E”
- Kabllo do të instalohen në një shtresë me kontakt midis tyre

#### **Kuadrot e kateve dhe kuadrot e mekanikës**

Pas sistemit të kabllove në kanalrat ato janë fiksuar me lidhëse plastike.

#### **Kuadrot e kateve.**

Kuadrot e kateve do të instalohen në ambiente elektrike të kateve perkatese. Duke u nisur nga llojet e burimeve kuadrot e kateve janë me seksionet e mëposhtme:

- Kuadri katit nëntokë seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i emergjencës ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2 )
- Kuadri katit nëntokë seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i emergjencës ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2 )
- Kuadri katit përdhe seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i emergjencës ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2 )
  - ✓ Seksioni i “sigurisë” ( furnizim nga kuadri i UPS3 )
- Kuadri katit përdhe seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i emergjencës ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2 )
  - ✓ Seksioni i “sigurisë” ( furnizim nga kuadri i UPS3 )
- Kuadri katit për seksionin CNC:
  - ✓ Seksioni i emergjencës ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2 )
- Kuadri katit për seksionin OST:
  - ✓ Seksioni i emergjencës ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )

- ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri I UPS1 ose UPS2 )

### **Kuadrot e mekanikes**

- Kondicionimi seksioni CNC
  - ✓ Seksioni normal ( furnizim nga seksioni i nenstacionit )
  - ✓ Seksioni i “emergjences” furnizim nga seksioni GEN I KKTU)
- Kondicionimi seksioni OST
  - ✓ Seksioni normal ( furnizim nga seksioni I nenstacionit )
  - ✓ Seksioni i “emergjences” (furnizim nga seksioni GEN I KKTU)
- MKZ.
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim nga seksioni GEN KKTU )
- Pompat e ujit, drenazhit dhe ujerave te zeza
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim nga seksioni GEN KKTU )

Kuadrot elektrike jane te gjithë metalike. Ne vartesi te madhësisë se tyre është bere edhe instalimi. Kuadrot e medhenj do te instalohen ne toke ndërsa kuadrot e vegjel do te instalohen te varur. Përvec kuadrove te siperpermendur, ne ambiente te vecanta jane instaluar kuadro elektrike per pavaresi nga kuadrot e kateve si dhe per kerkesa te vecanta te ambienteve. Keto ambiente pershkruhen si me poshte:

- Kuadri i SCADA katit perdhe seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuare” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri katit perdhe seksioni CNC )
  - ✓ Seksioni “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni CNC)
- Kuadri i TLC katit perdhe seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri i katit perdhe seksioni CNC )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni i UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni CNC )
- Kuadri i TM katit perdhe seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST)
- Kuadri i IT katit perdhe seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri katit perdhe seksioni OST )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
- Kuadri i 220/48V katit nentoke ambjenti 3BE seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST )



- Kuadri i 220/48V katit nentoke ambienti 12LTF seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni i UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
- Kuadri i BARIT katit perdhe OST:
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim seksioni i GEN KKTU )
- Kuadri i ndricimit te jashte katit nentoke ambjenti i KKTU:
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim seksioni i GEN KKTU )

### **Rrjeti furnizues i TU (ndricim – fuqi motorike)**

Rrjeti furnizues i tensionit te ulet sherben per furnizimn me energji te ndricimit, vendeve te punes dhe fuqive te ndryshme motorike te instaluara ne godine.

#### *Ndricimi*

Ndricimi i godines eshte konceptuar ne perputhje me kerkesat arkitektonike dhe kerkesat per sasine e ndricimit ne godine sipas ambienteve.

- Zyrat 500lux
- Koridore dhe shkalle 200lux
- Ambjentet sanitare 200lux
- Arkivet 300lux
- Magazinat 200lux
- Ambjentet mekanike 200lux

Rrjeti i ndricimit eshte ndertuar prej kablli me izolim dhe veshje PVC/PVC me izolacion 400/750V. Per shperndarjen e linjave te ndricimit ne koridor dhe nga ana e tavanit te hapshem eshte instaluar nje kanaline rrjete. Per furnizimin e linjave nga kanalina deri tek ndricuesi i pare, I linja e kabllit te ndricimit eshte instaluar drejteperdrejt ne tavan me aksesoret e pershtatshem per fiksime. Ne abientet mekanike dhe elektrike instalimi i ndricimit eshte i jashtem. Per realizimin e mbrojtjes mekanike te kablllove ato jane kaluar ne tub rigid PVC.

Per shperndarje e te njejtes linje ne drejtime te ndryshem jane perdorur kuti shperndares PVC 10x10cm.

Pajisjet e komandimit jane instaluar brenda murit, per arsye sigurie eshte instaluar ne tub fleksibel ne pjesen e linjes brenda murit. Lartesia e montimit te pajisjeve te komandimit te ndricimit eshte 1.1m.

Ndricimi furnizohet nga kuadri i katit sipas seksionit te godines. Furnizimi eshte bere nga seksioni i “emergjences”.

### **Ambientet e perbashketa te punes**

Per ndricimin e ambienteve te hapura te punes jane perdorur ndicues linear me grille alumini. Ato jane te vazhueshem ne perputhje me kerkesat arkitektonike. Ne keto ambiente do te instalohen dy rreshta ndricuesish te vazhdueshem me fuqi 2x28W.

Ndicuesit jane me llampe floureshente me ndricim te ngrohte.

Komandimi i ndricimit per keto zona eshte bere me pulsant qe jane instaluar lokalisht ne hyrje dhe ne dalje te ambienteve. Ne krahe te pulsanteve jane instaluar edhe reostat per ndryshimin e fuqise se ndricimit.

#### **Zyrat dhe sallat e mbledhjes.**

Ne zyrat e mbyllura dhe sallat e mbledhjeve jane instaluar ndricues te pershtatshem per tavan te varur 60x60cm, 4x14W.

Ndricuesit e ketyre ambienteve jane tip me grille alumini. Llambat e ndricuesave jane floureshent me ndricim te ngrohte.

Komandimi i ndricimit per keto ambiente behet me celes.

#### **Koridoret.**

Perzgjedhja e ndricimit te koridoreve per katin per dhe katin e pare eshte bere ne perputhje me kerkesat arkitektonike.

Ndricimi i ketyre koridoreve eshte i fshehte me ndicim indirekt. Ne pjesen e thyer te tavanit te varur do te instalohen llampa floureshente 14/28/35W.

Komandimi i ketij ndricimi eshte bere ne te njejtat pika si ne ambientet e perbashketa te punes me buton.

Ne keto koridore ne mes te gjeresise se tavanit te varur dhe ne mes te gjatesise se dy kollonave eshte instaluar nje ndricues led 1x15W. Ky ndricues do te furnizohet nga seksioni i UPS 1&2 dhe do te sherbeje si ndricues emergjence, ndricuesi nuk do te kete komandim dhe do te perdoret edhe si ndricim nate.

Ne katin nen toke ne pjesen e koridorit me tavan te varur ndricuesit jane me fuqi 2x26W. Ne koridoret pa tavan te varur ndricuesit jane industrial 1x58W.

#### **Shkallet**

Ndricimi i shkalleve eshte bere me ndricues tip led ne shkallet qendrore dhe te pershtatshem per ndricim te jashtem.

Furnizimi ndricueseve te shkalles eshte bere nga seksioni i UPS 1&2 dhe jane te pakomandushem.

#### **Ambientet sanitare.**

Ndricimi i ambienteve sanitare eshte bere me ndricues led 8W per parabanjot – lavaman dhe led 8W per ambientin e WC.

Ne parabanjo te cdo grupi banjosh do te instalohet i njejtat ndricues led 8W me furnizim nga seksioni i UPS 1&2.

Komandimi lokal i ndricimit eshte bere me celes lokal.

#### **Arkivat**

Ndricimi i arkivave eshte bere me ndricues 4x18W me llampe floureshente me ndricim te ngrohte.

Ne keto ambiente eshte parashikuar furnizimi i ndricimit nga seksioni UPS1&2.

Komandimi i ndricimit ne keto ambiente eshte bere me buton.

### **Magazinat**

Ndricimi i magazinave eshte bere ne varesi te tavanit te varur, me ndricues 4x18W ne rast se do te kemi tavan te varur dhe ndricues industrial nese ambienti nuk ka tavan te varur.

Komandimi i ndricimit eshte bere me celesa lokal.

### **Ambientet mekanike.**

Ndricimi i ambienteve mekanike eshte bere me ndricues industrial IP 65 1x49W me llampe floureshemte te ngrohte.

Komandimi i ndricimit ne keto ambiente eshte bere me celes lokal.

### **Ndricimi i emergjences**

Ndricimi i ergjences eshte i ndare ne:

- Ndricimi i emergjences
- Ndricimi i sinjalistikes se daljeve te emergjences.

Ndricimi i emergjences sic e pershkruam edhe me larte eshte bere ne vartesi te ambientit.

Ndricimi i sinjalistikes se daljeve te emergjences eshte bere me instalimin e ndricuesave 8W ne daljet e emergjences dhe ne ndryshimin e drejtimit horizontal dhe vertical me sinjalistiken perkatese.

### **Prizat e vendeve te punes dhe te sherbimit.**

Rrjeti i prizave te vendeve te punes dhe te sherbimit eshte ndertuar prej kablli me izolim dhe veshje PVC/PVC me izolacion 400/750V.

Shperndarja e linjave te prizave eshte bere poshte dyshemese se ngritur ne koridor nepermjet kanalines rrjetit ku jane instaluar. Dimensionimi i kanalines eshte ne varesi te sasise se kablllove qe jane instaluar ne kanaline. Pjesa e linjave furnizuese nga kanalina rrjete deri tek prize furnizuese eshte bere me guaino ose tub fleksibel. Ne ambientet mekanike dhe elektrike instalimi i ndricimit eshte i jashtem. Per realizimin e mbrojtjes mekanike te kablllove ato eshte kaluar ne tub rigid PVC. Per shperndarjen e te njejtës linje ne drejtime te ndryshem jane perdorur kuti shperndares PVC 10x10cm.

Per cdo vend pune jane parashikuar dy priza me ngjyre te bardhe qe do te furnizohen nga seksioni “emergjences” dhe dy priza me ngjyre te kuqe qe do te furnizohen nga seksioni i “privilegjuar”

Ne varesi te ambientit eshte bere edhe menyra e instalimit.

### **Ambientet e perbashketa te punes**

Ne ambientin e perbashket te punes prizat e vendeve te punes jane instaluar ne nje kuti dyshemeje te pershtatshme per dysheme te ngritur. Madhesia e kutise eshte e tille qe mund te instalohen kater prize shuko dy moduleshe dhe kater priza RJ45 nje moduleshe.

### **Zyrat dhe sallat e mbledhjes.**

Ne zyrat e mbyllura jane instaluar priza per cdo vend pune. Instalimi eshte bere ne varesi te pozicionit te zyres. Ne parim prizat e vendeve te punes jane instaluar ne mure ne lartesi 40cm nga dyshemeja. Ne rast se kjo menyre instalimi eshte e pamundur prizat e vendeve te punes jane instaluar ne kuti dyshemeje si tek ambientet e perbashketa te punes. Per nevojat e pastrimit te zyrave ne drejtim me celesin e komandimit te ndricimit dhe ne lartesi 40cm nga dyshemeja eshte

instaluar nje prize sherbimi ne njejen linje me vendet e punes dhe furnizim nga seksioni i “emergjences”.

Ne sallat e mbledhjes jane instaluar nje kuti dysHEMEJE me prizat si ne vendet e punes.

#### **Koridoret.**

Ne largesi cdo 20m dhe lartesi 40cm nga dysHEMEJA jane instaluar priza sherbimi (pastrami). Keto priza furnizohen nga seksioni i “emergjences” dhe jane te bardha.

Ne abientet e koridorit ku jane pashikuar fotokopjet dhe printerat jane instaluar ne lartesi 120cm nga dysHEMEJA prizz schuko. Keto priza do te furnizohen nga seksioni i “emergjences”.

#### **Ambientet sanitare.**

Ne ambientet sanitare do te parashikohet linja furnizuese e drejteperdrejte nga kuadri elektrik seksioni i “emergjences” tek boileret elektrike dhe tharesat elektrik te duareve.

#### **Arkivat**

Ne keto ambiente jane parashikuar instalimi i prizave te sherbimit me furnizim nga seksioni i “emergjences”.

#### **Magazinat**

Ne keto ambiente jane parashikuar instalimi i prizave te sherbimit me furnizim nga seksioni i “emergjences”.

#### **Ambientet mekanike.**

Ne krahe te pikes se komandimit te ndricimit ne ambjentet mekanike dhe elektrike jane instaluar nje prize e jashteme 220V dhe nje prize 3Ph/N/PE 400V.

Furnizimi i ketyre prizave eshte bere nga seksioni i “emergjences”.

#### **Fuqite motorike**

##### **Pajisjet e kondicionimit VRF.**

Pajisjet e kondicionimit te cdo seksioni furnizohen nga kuadrot elektrike perkates.

Pajisjet e kondicionimi furnizohen me kabell me izolim dhe veshje PVC/PVC me tension izolimi 0.6 kV. Keto kablllo nepermjet saftit te mekanikes dalin ne taracen e godines. Shperndarja eshte bere me ndihmen e nje kanaline metalike te zinkuar ne te ngrohte dhe me kapak.

Furnizimi i ketyre paisjeve eshte bere nga seksioni “normal”.

Pajisjet e brendshme te kondicionimit do te furnizohen nga kuadrot e kateve me kabell me izolim dhe veshje PVC/PVC me tension izolimi 450/750V. Instalimi i ketyre linjave eshte bere nepermjet kanalave rrjete tavanore dhe nga kanalina deri tek paisja kablli eshte instaluar direkt ne tavan.

##### **Pajisjet e trajtimit te ajrit dhe ventilatoret.**

Pajisjet e trajtimit te ajrit te cdo seksioni furnizohen nga kuadrot elektrike perkates..

Pajisjet e kondicionimi furnizohen me kabell me izolim dhe veshje PVC/PVC me tension izolimi 0.6 kV. Keto kablllo nepermjet saftit te mekanikes dalin ne taracen e godines. Shperndarja eshte bere me ndihmen e nje kanaline metalike te zinkuar ne te ngrohte dhe me kapak.

Furnizimi i ketyre paisjeve eshte bere nga seksioni i “emergjences”

## **Tokezimi dhe mbrojtja nga rrufete.**

Sistemet kane per qellimin mbrojtjen e jetes humane, garantimin e funksionimit normal te sistemit elektrik dhe mbrojtjen e godines nga goditjet atmosferike.

### **Tokezimi i punes**

Ne anen jugperendimore te godines dhe ngjitur me murin mbajtes do te instalohen kater shufra tokezimi te zinkuara ne te ngrohete me gjatesi 1.5m. Distanca e montimit te shufrave te tokezimit ndermjet tyre eshte 6m. Shufrat e tokezimit lidhen ndermjet tyre me shirit te zinkuar ne te ngrohete me permasa 30x3mm.

Ne kete shirit eshte lidhur edhe ylli i gjeneratorit.

Duke shfrytezuar hyrjet ne godine te kablllove te gjeneratorit eshte mundesuar edhe hyrja ne godine e tokezimit te punes. Tokezimi i punes lidhet me kolektorin e tokezimit i cili do te instalohet ne dhomen e transformatoreve ne lartesi 50cm nga niveli i dyshemese perfundimtare.

Ne kete kolektor lidhet ylli i transformatoreve 800kVA. Dimensioni i kabllit te tokezimit te yllit te transformatorit tregohet ne vizatimet perkatese.

Rezistenca e tokezimit te punes eshte me e vogel se  $2\Omega$ .

### **Tokezimi ekuipotencial**

Per barazimin e potenciale elektrike ne te gjithë pjesët metalike te ambjenteve elektrike si dhe te pajisjeve metalike ne te cilat egziston mundesia te bien nen tension si dhe per menjanimin e diferences se potencialeve ne dysheme eshte instaluar sistemi i tokezimit ekuipotencial. Nje percjelles i zhveshur bakri me gjatesi rreth 100m eshte instaluar ne trasene e kabllit te tensionit te mesem. Ky percjelles eshte perdorur si tokezim ekuipotencial. Ne raste se dy tokezimet te bashkuara kane nje rezistence tokezimi me te vogel se  $1\Omega$  keto tokezime jane te bashkuara.

### **Ambientet elektrike.**

Ne te gjitha ambientet elektrike eshte instaluar nje kolektor tokezimi ne lartesi 50cm nga dyshemeja perfundimtare. Ne kete kolektor lidhen te gjithë pjesët dhe pajisjet metalike qe ndodhen ne keto ambjente.

### **Kanalinat metalike.**

Ne ndryshimet e niveleve dhe te drejtimit te kanalines ku eshte e pamundur lidhja e ngurte e kanalines per barazimin e potencialeve elektrike do te perdoren ura lidhese fleksibele me percjelle  $16\text{mm}^2$ .

### **Mbrojtja rrufe**

Ne baze te standartit EN-60235-2 dhe rendesise objekti ben pjese ne kategorine I te rezikut godites nga rrufeja.

Ne baze te kesaj perzgjedhjeje ne godine do te instalohet nje rrufeprites tip “pulsar” sic tregohet ne vizatimet perkatese.

Rrjeti zbrites i sistemit te mbrojtjes nga rrufeja eshte i dyfishte dhe do te ndertohet nga shirit percjelles tokezimi  $\text{Cu } 95\text{mm}^2$ .

Per shkarkimin e ngarkesave elektrike gjate goditjes rrufe do te ndrertohen dy tokezime te pavarura nje per cdo zbritje. Secili tokezim do te ndertohet nga elektroda tokezimi 1.5m te montuara ne largesi 6m ndermjet tyre.

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrolle dhe matje periodike ne te gjitha pajisjet e sistemit, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Frekuenca (here vit)
1	<b>Kontroll periodik viziv dhe riparim i celave te tensionit te mesem.</b>	cope	2	12
2	<b>Matje izolacioni tek celat e tensionit te mesem.</b>	cope	2	1
3	<b>Kontroll periodik viziv I transformatoreve 800 kVA</b>	cope	2	12
4	<b>Matje izolacioni tek transformaret 800 kVA</b>	cope	2	1
5	<b>Kontroll viziv dhe riparim i celave te mbrojtjes se transformatoreve.</b>	cope	2	12
6	<b>Matje periodike e karakteristikeve te blloqeve te kondesatoreve.</b>	cope	2	4
7	<b>Kontroll viziv dhe riparim i kuadrit kryesor te tensionit te ulet</b>	cope	1	12
8	<b>Matje izolacioni e kuadrit kryesor te tensionit te ulet.</b>	cope	1	1
9	<b>Kontroll periodik viziv dhe riparim i paneleve te tensionit te ulet</b>	cope	28	12
10	<b>Matje izolacioni tek panelet e tensionit te ulet.</b>	cope	28	1
11	<b>Kontrolli kontakteve dhe shterngimi I tyre tek panelet e tensionit te ulet.</b>	cope	28	4

12	<b>Kontroll periodik I filtrave te ajrit, vajit dhe naftes se gjeneratorit te emergjences 400 kVA</b>	cope	1	2
13	<b>Kontrolli i nivelit te vajit dhe te ujit te motorit te gjeneratorit te emergjences.</b>	cope	1	12
14	<b>Kontrolli periodik dhe riparim i UPS 120 kVA</b>	cope	2	12
15	<b>Kontrolli periodik dhe riparim i UPS 20 kVA</b>	cope	1	12
16	<b>Kontrolli periodik dhe riparim i kuadrit kryesor te UPS-ve.</b>	cope	1	12
17	<b>Kontrolli periodik I sistemit te furnizimit 48 V (radrizatoret)</b>	cope	1	12
18	<b>Matja periodike e karakteristikave dhe sherbimi i grupit te baterive per UPS 120 kVA</b>	cope	2	2
19	<b>Matja periodike e karakteristikave dhe sherbimi i grupit te baterive per UPS 20 kVA</b>	cope	1	2
20	<b>Matja periodike e rezistences se tokezimit.</b>	komplet	1	1

**Sistemi i mbyllur i kamerave dhe sistemi i sigurise (dedektimit i hyrjes ne godine).**

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrole periodike dhe riparime te te gjitha pajisjeve te sistemit, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Frekuenca (here vit)</b>
------------	-------------------	---------------	--------------	-----------------------------

<b>1</b>	<b>Kontroll dhe riparim I kamerave te instaluara ne godine (brenda dhe jashte)</b>	<b>cope</b>	<b>22</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i centralit monitorues NVR</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Kontroll dhe riparim i dedektoreve tip barrier te instaluar jashte godines.</b>	<b>cope</b>	<b>6</b>	<b>2</b>
<b>4</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i sensoreve volumetrike te levizjes.</b>	<b>cope</b>	<b>36</b>	<b>2</b>
<b>5</b>	<b>Kontrolli periodik dhe riparim I sirenave te sigurise (te brendshme dhe te jashtme).</b>	<b>cope</b>	<b>7</b>	<b>2</b>
<b>6</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i sensoreve te dedektimit te ujit.</b>	<b>cope</b>	<b>42</b>	<b>2</b>
<b>7</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i kontakteve magnetike te deres.</b>	<b>cope</b>	<b>5</b>	<b>2</b>
<b>8</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i paneleve te kontrollit te sigurise.</b>	<b>cope</b>	<b>6</b>	<b>2</b>
<b>9</b>	<b>Kontroll dhe riparim te sistemit te akses kontrollit (perfshire akses controllet 4 cope si dhe 12 reader te dyerve dhe 4 tripoda</b>	<b>cope</b>	<b>4</b>	<b>2</b>

### **Sistemi i transmetimit te dhenave dhe centrali telefonik i brendshem**

Eshte parashikuar ndertimi i nje rrjeti kabllor i cili eshte ne gjendje te mbuloj nevojat e godines per telefoni dhe transmentimin e te dhenave si per rrjetin e brendshem ashtu edhe furnizimet e jashteme nga rrjetet publike.

Projektimi i sistemit ka per qellim kabllimet e sistemit brenda godines terminimet dhe lidhjet e tyre ne menyre qe te ndertohet nje rjete fleksibel per transmentimin e te dhenave dhe telefonise.



Rrjeti shperndares eshte pjesa pergjegjese per transmentimin e sakte ndermjet pjeseve aktive dhe si perfundim ndaj perdoruesit.

Pjeset perberese te sistemit:

- Pike lidhje me fiber optike tek venderoja ne hyrje te godines.
- Lidhjeme fiber optike ndermjet dhomes se srver-ave dhe 4 dhomave ku jane te vendosura patch-panelrakeve
- Lidhjet kabllore nga vendet e punes ne drejtim te rakeve
- Lidhjet e vendeve te punes te vecanta me serverat perkates.

Pervec serverave data me perdorim te pergjitheshem ne godine jane instaluar edhe serverat:

- Scada
- TLC
- TELEMETERING

Shperndarja e rrjetit telefoni-data eshte ne varesi te rrjetit qe sherben. Ne godine jane instaluar rrjetet e meposhteme:

- Rrjeti i transmentimit te dhenave dhe telefonise
- Rrjeti i transmentimit te dhenave scada
- Rrjeti i transmentimit te dhenave TLC
- Rrjeti i transmentimit te dhenave TELEMETERING

### **Rrjeti i transmetimit te dhenave dhe telefonise**

Ne katin perdhe te seksionit te OST jane instaluar serverat e shkembimit te dhenave Ne katet perdhene katin e pare dhe te dyte jane te vendosur kabintetet *rack* te data-telefoni. Secili nga raket eshte i ndare ne menyre fizike ne seksionin data dhe ne seksionin e telefonise. Secili nga seksionet e cdo raku lidhet me dhomen e server-ave duke shfrytezyar fiber optike *multi mode*. Furnizimi i vendeve te punes realizohet per rrjetin data me kabell FTP Cat 6, ndersa per telefonat e vendeve te punes realizohet me kabell UTP Cat 5. Kabllote jane te instaluara ne kanalinen e rrjeteve te rrymave te dobeta dhe ne hapesiren e perbashket jane te instaluara ne kanaline te vecante .

### **Rrjeti i te dhenave SCADA**

Ky rrjet ndertohet ne te njejten menyre si rrjeti data. Ai eshte me kabell FTP Cat 6. Kabllot jane te instaluara ne kanalinen metalike rrjete te rrymave te dobeta qe eshte instaluar poshte dyshemese se ngritur dhe me guaine ose tub fleksibel nga kanalina deri tek vendi i punes. Racku i serverave eshte i instaluar ne katin perdhe ne ambientin “scada” seksioni CNC.

### **Rrjeti i te dhenave TLC**

Ky rrjet eshte i dizenuar ne te njejten menyre si rrjeti data. Ai eshte me kabell FTP Cat 6. Kabllot jane te instaluara ne kanalinen metalike rrjete te rrymave te dobeta qe eshte instaluar poshte

dyshemese se ngritur dhe me guain ose tub fleksibel nga kanalina deri tek vendi i punes. Racku i serverave data eshte i instaluar ne katin perdhe ne ambientin “TLC” seksioni CNC.

### **Rrjeti i te dhenave Telemetering**

Ky rrjete eshte i dizenuar ne te njejten menyre si rrjeti data. Ai eshte me kabell FTP Cat 6. Kabllot jane te instaluara ne kanalinen metalike rrjete te rrymave te dobeta qe eshte instaluar poshte dyshemese se ngritur dhe me guaine ose tub fleksibel nga kanalina deri tek vendi i punes. Racku i serverave data eshte i instaluar ne katin perdhe ne ambientin “TELEMETERING” seksioni OST.

### **Sistemi i ashensoreve**

Ne godine jane intaluar kater ashensore me kapacitet 450 kg (6 persona). Keta ashensore jane instaluar nga 2 per secilin seksion te godines. Operimi i tyre eshte per te tre katet e godines (-1,0 dhe 1).

### **Sistemi i dyerve automatike te godines**

Ne godine jane te instaluara tre porta me komandim automatik. Porta e pare eshte ajo e jashtme, e cila komandohet automatikisht nga godina e vendrojes qe ndodhet aty prane. Kjo porte sherben per lejimin e hyrjes se makinave dhe njerezve nga rruga ne parkimin e brendshem te godines.

Porta tjetere perbehet nga dy porta te lehta rreshqitese ( secila me peshe deri ne 125 kg) me kontroll me mikroprocesore, te cilat sherbejne per hyrjen e personave nga oborri i godines ne brendesi te saj.

Pas kesaj porte jane instaluar kater porta te tjera te tipit te rrotullueshme me tre kembe. Keto jane instaluar nga dy porta per secilin seksion te godines. Keto porta komandohen me kartat personale te punonjesve.

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrole periodike dhe riparime te te gjitha pajisjeve te sistemit, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Frekuenca (here vit)</b>
<b>1</b>	<b>Lubrifikimi I motorit te deres levizese te jashtme.</b>	<b>cope</b>	<b>1</b>	<b>1</b>
<b>2</b>	<b>Kontroll dhe riparim I sensoreve te pozicionit.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Kontrolli I pjeseve mekanike kremalier - pinjon</b>	<b>cope</b>	<b>1</b>	<b>2</b>
<b>4</b>	<b>Lubrifikimi i motoreve te dyerve te lehta rreshqitese ne hyrje te godines.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>1</b>

<b>5</b>	<b>Kontroll dhe riparim I sensoreve te pozicionit.</b>	<b>cope</b>	<b>4</b>	<b>2</b>
<b>6</b>	<b>Kontrolli I shinave ku leviz porta.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>7</b>	<b>Kontroll dhe riparim I mekanizmit te portave te rrotullueshme</b>	<b>cope</b>	<b>4</b>	<b>2</b>
<b>8</b>	<b>Mirembajtje e traut hyres</b>	<b>set</b>	<b>1</b>	<b>4</b>

**Sherbime te tjera te godines (punime ndertimore).**

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrole periodike dhe riparime te gjithë pjeseve ndertimore te godines, si dyer, dritare, dysheme, etj, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Frekuenca (here vit)</b>
<b>1</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dyer druri.</b>	<b>cope</b>	<b>112</b>	<b>1</b>
<b>2</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dyer metalike.</b>	<b>cope</b>	<b>13</b>	<b>1</b>
<b>3</b>	<b>kontroll viziv I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dyer emergjence..</b>	<b>cope</b>	<b>6</b>	<b>1</b>
<b>4</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim I fleteve mbledhese per dyert qepen.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>5</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dritaret.</b>	<b>cope</b>	<b>129</b>	<b>1</b>
<b>6</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim per difekte te tavanit te plote te gipsit.</b>	<b>m2</b>	<b>3500</b>	<b>1</b>

7	<b>kontroll per demtim dhe riparim I pllakave te tavanit modular 60x60.</b>	<b>m2</b>	<b>2650</b>	<b>1</b>
8	<b>kontroll per demtim dhe riparim i pllakave te dyshemese</b>	<b>m2</b>	<b>3308</b>	<b>1</b>
9	<b>kontroll per demtim dhe riparim i dyshemese teknike</b>	<b>m2</b>	<b>4400</b>	<b>1</b>
10	<b>kontroll per demtime i dyshemese parket</b>	<b>m2</b>	<b>460</b>	<b>1</b>
11	<b>kontroll per demtim dhe riparim i mureve te suvatuara.</b>	<b>m2</b>	<b>15900</b>	<b>1</b>

### Sistemi i ventilimit per sallën e Dispeçerisë

Sistemi i ventilimit i instaluar nuk është efikas, sepse mungon tubacioni i heqjes së ajrit të prishur si edhe sasia e ajrit të freskët ( $1500 \text{ m}^3 / \text{orë}$ ) që futet është e vogël dhe si rrjedhojë ajri i sallës ndërrohet një herë në orë.

Bazuar në vlerësimet e bëra nga grupi i punës dhe rëndësinë që ka salla e dispeçerisë, do të duhet të instalohet një sistem të ri ventilimi me kapacitet  $5000 \text{ m}^3/\text{orë}$ . Preventivi i punimeve që do të kryhen është dhënë në dokumentin: “Tabela e mirëmbajtjes së godinës”.

Duke qenë se do të kryhen punime ndërtimore brenda godinës së OST-së dhe në vende ku janë instaluar edhe rrjete të tjera inxhinjrike dhe me qëllim që të mos kemi dëmtime gjatë kryerjes së punimeve duhet që:

- Kompanitë që do të shprehin interesin për të marrë pjesë në garë do të duhet që para se të japin ofertën të bëjnë një vizitë pranë zyrave të OST-së në një datë të paracaktuar, me qëllim që ti shpjegohen me hollësi aktivitetet që do të kryhen. Kjo do të ndihmojë në përcaktimin e metodologjisë së duhur për kryerjen e punimeve.
- Pas kryerjes së punimeve çdo gjë do të rikthehet në statusin që kishte para fillimit të punimeve.

Specifikimet teknike të pajisjeve dhe materialeve:

1. Shkëmbyes nxehtësie  $Q=5000\text{m}^3/\text{h}$ ,  $P=400\text{Pa}$ , fuqia e motorit të ventilatorëve  $1,5 \text{ kW}$  dhe parangrohësi me fuqi  $N=25\text{kW}$ . Shkëmbyesi i nxehtësisë do jetë me fletë alumini, muret dyshe me materiale termoizoluese dhe i pajisur me rezistencë elektrike.

2. Tubi i dërgimit dhe i kthimit do të jenë prej materiali çelik i zinkuar, të termoizoluar me trashësi  $\delta = 0,6\text{mm}$  dhe diametër  $\Phi 450\text{ mm}$ .
3. Termoizolimi për tubacionet do të jetë tip i gomuar me trashësi  $\delta = 9\text{mm}$ .
4. Grila alumini 60x20 cm me 2R.
5. Brryla 450mm, rrethor  $90^\circ$ , me tre segmente
6. Aksesorë për montimin e linjave të dërgimit dhe kthimit. Shufra të filetura, bullona, profile L, nastro alumini, perçina,.. etj.
7. Punimet elektrike do të përbëhen nga furnizim vendosje:
  - Lëshues elektromagnetik 63A,3F
  - Automat 63 A,3F, 4P
  - Kabëll 4x10mm, 25 kW
  - Tel 10mm
  - Nëse do të ketë nevojë për ndonjë përshtatje tjetër të panelit elektrik ato do të kryhen nga kontratori pa kosto shtesë.

### III. Bazat e termave të references (Objektivat)

Detyra e kompanisë që do të kryejë mirëmbajtjen e Impjanteve të godinës është që të gjitha sistemet të përkrahura këtu me sipër të funksionojnë në mënyrë korrekte dhe të përpunueshme duke siguruar kështu optimizimin e kushteve të punës, duke plotësuar objektivat e mëposhtme:

- Funksionimi korrekt, përpunueshmëri dhe në kushte sigurie të të gjitha sistemeve të godinës të përkrahura këtu me sipër.
- Kryerja e të gjithë procedurave të mirëmbajtjes në një kohë që nuk interferojnë me aktivitetin e kryer në godinë nga ana e punonjësve të kompanisë OST.
- Mbajtja e një performante të lartë operimi të të gjithë sistemeve edhe pas ndërhyrjeve profilaktike që do të kryhen.
- Trajnimi i punonjësve të dedikuar të OST-se për mirëmbajtjen e sistemeve të sipërcituara.

### IV. Qëllimi i punës së shërbimit që do të ofrohet

Këto terma referencë mbulojnë qëllimin e shërbimit që do të ofrohet dhe strukturën e këtij shërbimi të detajuar për çdo sistem të godinës.

1. Shërbime periodike në të gjitha sistemet konform manualeve të operimit dhe mirëmbajtjes.
2. Raportimi periodik me shkrim i të gjitha ndërhyrjeve të kryera, duke hapur libra të posaçëm pune për secilin sistem. Këto libra do të vendosen në çdo kohë në dispozicion Administratorit të Kontrates dhe në përfundim të kontrates do të mbeten OST-se.

Aktivitetet e kryera do të konsistojnë në shërbime periodike të sistemeve, në furnizimin dhe vendosjen e materialeve të konsumueshme që shërbejnë për operimin korrekt të impianteve si edhe në furnizimin dhe vendosjen e pjesëve të demtuara, të cilat do të jepen në një listë të veçante në dokumentat e tenderit. Të gjitha këto shërbime do të kryhen konform manualeve të operimit dhe mirëmbajtjes për çdo sistem.

Investitori do të verë në dispozicion të kompanisë fituese të gjitha materialet teknike të nevojshme për mirëmbajtjen e sistemeve të përkruara. Këto materiale do të përfshijnë të gjitha vizatimet perfundimtare të sistemeve si edhe manualët e operimit dhe mirëmbajtjes.

Nga ana e investitorit do të caktohet një person përgjegjës “Administratori i Kontrates”, i cili do të mbajë kontaktet me kompaninë që do të kryejë shërbimin e impianteve të godinës dhe do të certifikojë çdo punë të saj.

Kontratori duhet të paraqesë gjithmone një skedul kohor të aktiviteteve që do të kryejë, i cili duhet të miratohet nga investitori.

Në tabelën bashkelidhur do të përkruajmë të gjitha aktivitetet që do të kryhen për çdo sistem.

## V. Kërkesat për ekspertizë

Kompania që do të kryejë shërbimin e sistemeve të lartpërmendura duhet që të ketë një eksperiencë disavjecare në këto fushë. Ajo duhet që të ketë realizuar me sukses kontrata shërbimi të impianteve të ventilimit dhe ajrit të kondicionuar, impianteve hidraulike, impianteve të mbrojtjes kundër zjarrit dhe impianteve elektrike të tensionit të mesëm e të ulët. Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të ashensoreve mund të kryhet edhe nga kompani nenkontratore të specializuara. Kërkesat për ekspertizë për kompaninë që do të kryejë punimet për instalimin e sistemit të ventilimit për sallën e dispečerisë do të gjenden në dokumentat e tenderit.

Shërbimi do të konceptohet duke patur dy persona fiks çdo ditë në godinë dhe persona të tjerë eksperte të sistemeve të lartpërmendura të cilat do të nderhyjnë në kohën e duhur për zgjidhjen e problemeve.

Njeri prej personave që do të jetë fiks në godinë do të monitorojë të gjithë funksionimin e sistemeve të godinës nga njesia kompjuterike BMS, ndërsa tjetri do të monitorojë fizikisht të gjitha sistemet dhe do të nderhyjë në rast se do të ketë probleme. Këta persona duhet të jenë të specializuar dhe të kenë aftësitë e mëposhtme:

- Të kenë aftësi të mira kompjuterike dhe të njohin monitorimin dhe operimin e sistemeve në distancë, pasi do të punojnë tek njesia kompjuterike, e cila menaxhon të gjitha sistemet e godinës.
- Të jenë të aftë që të vënë në punë të gjitha sistemet që mund të kalojnë në gjendje alarmi ose “trip”, duke kryer nderhyrjet e kerkuara për çdo rast.
- Të kenë një certifikatë e cila i autorizon që të operojnë me sistemin e antizjarrit.

Kompania duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme teknike për të kryer nderhyrjet e duhura në të gjitha sistemet si edhe për kryerjen e shërbimeve periodike sipas programit të miratuar.

**Shënim: Në respekt të nenit 23 të LPP – së, në të gjithë rastet kur në Specifikimet Teknike përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.**

## Shtojca 10

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

### PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____



## **Shtojca 11**

( *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*)

(*Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

### **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: **Sipas përshkrimit të formularit të ofertes dhe termave të referencës.**

Afatet e ekzekutimit: **12(dymbëdhjete) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates**

## Shtojca 12

( Shtojcë për t’u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

### **TERMAT E REFERENCËS**

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

#### **Mirëmbajtja e Impianteve të Godinës së OST-se**

##### **I. Operatori i Sistemit të Transmetimit**

Operatori i sistemit të transmetimit (OST) është një kompani publike me aksione 100% të shtetit shqiptar. OST u krijua në 14.07.2004 si rezultat i ndarjes së kompanisë KESH, e cila kishte një organizim vertikal me funksion prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, në tre kompani të vecanta.

OST performon si operator i sistemit të transmetimit, operator i sistemit dispecer dhe operator tregu.

OST garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- Furnizimin e pënderprere me energji për nënstationet e sistemit të shpërndarjes dhe klientet e lidhur drejtpërdrejt në rrjetin e transmetimit.
- Transmetimin e energjisë së prodhuar nga burime private.
- Gjithashtu garanton edhe shkëmbimet e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e tjera të rajonit.

##### **II. Informacion i përgjithshëm mbi Sistemet e Impianteve të Godinës**

Në godinën e re të OST-se të ndërtuar në komunën Kashar, në kilometrin e 9 të autostradës Tiranë – Durres janë instaluar disa sisteme dhe impiante mekanike, elektrike dhe hidraulike. Duke parë kompleksitetin e impianteve në godinë është instaluar edhe një sistem BMS (Building Managing System) për kontrollin dhe monitorimin e të gjitha impianteve të instaluar në godinë. Godina është e konceptuar me ambiente të përbashkëta pune (open space) dhe zyrë të vecanta. Godina është e ndarë në dy seksione: OST dhe qendra dispecer. Gjithashtu në godinë ka edhe një ambient (bar & restorant), laboratorë, arkivë, magazinë, etj. Godina është me tre kate përkatesisht -1, 0 dhe 1.

1. Sistemet e impianteve të instaluar në godinë janë të listuara këtu më poshtë:

- Sistemi i ventilimit dhe ajrit të kondicionuar (ngrohje dhe ftohje).
- Sistemi i furnizimit me ujë sanitar dhe impianti i trajtimit të ujit.
- Sistemi zjarrfikës.
- Sistemi i drenazhimit dhe shkarkimit të ujërave të bardha dhe të zeza dhe sistemi i vaditjes.

- Sistemi i mbyllur i kamerave dhe i dedektimit të hyrjes në godinë.
- Sistemi i transmetimit të dhenave dhe centrali telefonik i brendshëm
- Sistemi elektrik i ndricimit dhe i fuqisë.
- Sistemi i mbyllur i kamerave dhe sistemi i sigurisë (dedektimit i hyrjes në godinë).
- Sistemi i ashensoreve
- Sistemi i dërrave automatike të godinës

### **Sistemi i ventilimit dhe ajrit të kondicionuar ( ngrohje dhe ftohje).**

Sistemi ka si synim sigurimin e konfortit termik dhe cilësisë së ajrit në ambientet e zyrave, hapësirave të përbashkëta të punës, magazinave, arkivave, laboratoreve dhe ambienteve sanitare. Sistemi i kondicionimit garanton vetëm temperaturën dhe jo lagështirën e ajrit, përveç ambienteve të vecanta ku kërkohej ftohje me delageshtim.

Në sistemin e kondicionimit janë instaluar pajisjet e mëposhtme:

- Sistemi i kondicionimit me VRF ( VARIABLE REFRIGERENT FLOW ) për ambientet e zyrave dhe hapësirave të përbashkëta të punës.
- Sistem ftohje me VRF ( VARIABLE REFRIGERENT FLOW ) për ambientet e serverave
- Njësit split unit INV për venderojen.
- Njësitë trajtimit të ajrit AHU.
- Rimaresh energjie termike bashkë me ventilatorin.
- Ventilatorët e ambienteve sanitare.
- Rrjetin frigoriferik.
- Rrjetin e tubave të ajrit.

Kondicionimi (ngrohje-ftohje) i ambienteve të përbashkëta të punës dhe zyrave kryhet me sistemin e kondicionimit VRF ( VARIABLE REFRIGERENT FLOW ) me ekspansion të drejtepërdrejtë. Sistemi i kondicionimit funksionon me pompa nxehtësie INVERTER me gaz 410A dhe pajisje të brendshme në varesi të ambientit.

Përzgjedhja e këtyre pajisjeve është bërë duke marrë parasysh kërkesat dhe kohën e zbatimit të projektit. Karakteristikat e këtij sistemi janë listuar këtu me poshtë:

- Kërkesat për hapësira të vogla të instalimit, duke i lënë të gjitha hapësirat në përdorim shfrytëzuesit
- Rrezikshmeri të vogël për dëmtime të pajisjeve elektrike dhe elektronike (pajisje me kosto të larta) në rastë dëfektive në rrjetin hidraulik të transmetimit.
- Fleksibilitet të sistemit në lidhje me koordinimin me sistemet e tjera elektro – mekanike.
- Kohë të vogël instalimi.
- Kosto të ulët mirëmbajtje.
- Konsum të ulët energjie.
- Komunikim të thjeshtë me sistemin e menaxhimit të godinës.

## **Kondicionimi i ambienteve të perbashketa të punës dhe zyrave.**

Kondicionimi i godines eshte i ndare ne baze te seksioneve te godines dhe kateve te cdo seksioni. Ne taracen e cdo seksioni te godines jane instaluar pompat e nxehtesise INVERTER qe sherbejne per kondicionimin e ambienteve te seksionit. Keto pompa lidhen me njesite e brendshme nepermjet rrjetit frigoriferik. Per cdo kat te seksionit jane instaluar dy pompa nxehtesie.

Rrjeti frigoriferik eshte prej tubash bakri te termoizoluar te pershtatshem per instalime te sistemit te kondicionimit. Per instalimin e rrjetit frigoriferik jane perdorur aksesoret e nevojshem bashkues, degezues dhe brryla me dimensione sipas rrjetit. Instalimi i rrjetit frigoriferik eshte bere me stafa mbajtese per tubat e ngurte ndersa pjeset fleksibel jane te instaluara edhe direkt ne tavan.

Paisjet e brendshme jane te tipeve si me poshte:

- tavanore tip kasete me kater drejtime te fryrjes se ajrit.
- tip konsolle tek zyrat dhe tek salla e kontrollit
- tip kasete me dy drejtime te fryrjes se ajrit tek disa zyra ne katin nentoke.

Madhesite e pajisjeve te brendshme jane perzgjedhur ne varesi te humbjeve termike. Sasia e pajisjeve te brendshme per ambientet e perbashketa te punës dhe sellen e mbledhjeve eshte bere ne perputhje me kerkesat arkitektonike duke patur parasysh nje uniformitet ne shperndarjen e ajrit. Komandimi i njesive te brendshme realizohet ne menyre lokale nepermjet termostatit te ambientit por edhe ne menyre qendrore nepermjet BMS.

Per zyrat e mbyllura eshte instaluar nje termostat per cdo ambient ndersa per ambientet e perbashketa te punës dhe ne korridore eshte instaluar nje termostat ne piken me te larget nga pajisjet e brendshme.

### *Ambientet e Serverave dhe UPS*

Per keto ambiente eshte parashikuar qe te kryhet vetem ftohja.

Sic duket edhe nga projektet arkitektonike ambientet e serverave jane te ndara ne te dy seksionet e godines CNC dhe OST ne katin perdhe.

Per nevojat e ftohjes se pajisjeve elektronike te serverave SCADA dhe TLC dhe UPS ne taracen e seksionit CNC eshte instaluar pajisa e jashtme e kondicionimit me ekspansion te drejteperdrejte dhe gaz frigoriferik R410A. Kjo paisje lidhet me pajisjet e brendshme nepermjet rrjetit frigoriferik prej tubi bakri te pershtatshem per instalime kondicionimi.

Paisjet e brendshme qe jane instaluar ne keto ambjente jane tip tavanor (montim drejtperdrejte ne tavan).

Per nevojat e ftohjes se pajisjeve elektronike te serverave TELEMATJE dhe IT ne tarracen e seksionit OST eshte instaluar paisja e jashtme e kondicionimit me ekspansion te drejteperdrejte

dhe gaz frigoriferik R410A. Kjo pajisje lidhet me paisjet e brendshme nepermjet rrjetit frigoriferik prej tubi bakri te pershtatshem per instalime kondicionimi.

Pajisjet e brendshme qe jane instaluar ne keto ambiente jane tip tavanor (montim drejteperdrejte ne tavan).

Komandimi i njesive behet lokal nepermjet termostatit te ambientit dhe qendror nepermjet sistemit te menaxhimit BMS.

### **Bari (ngrohje dhe ftohje)**

Per arsye kontrolli, madhesie si edhe mundesise se shfryrezimit ne te ardhmen nga nje person fizik ose juridik jashte OST, kondicionimi i ketij ambienti behet ne menyre te pavarur.

Kondicionimi i ambienteve te barit behet nepermjet nje pompe nxehtesie INVERTER R410A qe eshte montuar ne tarracen e godines nga ana e seksionit te OST. Nepermjet tubave frigoriferik prej bakri behet lidhja me pajisjet e brendshme.

Pajisjet e brendshme jane tip kasete me kater drejtime te fryrjes se ajrit per kondicionim te drejteperdrejte dhe kanalore per futjen dhe nxjerrjen e ajrit te fresket.

Komandimi i njesive te brendshme kryhet ne menyre lokale me termostat ambientit dhe qendror nepermjet BMS.

Kondicionimi ambjentit te gatimit behet nepermjet grilave tranzit ne dyert hyrese nga ambjenti i barit.

#### *WC*

#### **Ajri i kondicionuar.**

Ajri i kondicionuar ne ambientet sanitare behet nepermjet grilave tranzit ne hyrjen kryesore dhe hapsires boshe te cdo dere.

#### *Arkiva*

Ne keto ambiente jane instaluar sisteme kondicionimi. Ne keto ambjente eshte parashikuar sistemi i de-lageshtimit per te mbajtur nivelin e lageshtires relative ne intervalin 40-45%.

#### *Magazina dhe ambientet teknike*

Ne keto ambiente nuk eshte parashikuar kondicionimi.

#### *Vendroja*

Per nevojat termike te ambjentit te vendrojes eshte instaluar nje njesi INVERTER tip multisplit.

#### *Rrjeti Frigoriferik*

Rrjeti frigoriferik eshte ndertuar me tuba bakri ndersa gazi frigoriferik i perdorur eshte R410A.

Tubat e bakrit jane pa tegel, te pershtatshem per sisteme kondicionimi me rezistence te mire karshi presionit te larte, me izolim termik ARMAFLEX dhe me spesor te pakten 9mm. Temperaturat e punes jane 120°C per linjat e gazit dhe 70°C per linjat e lengut.

Ne rrjetin frigoriferik per furnizimin e pajisjeve te brendeshme do te perdoren degezues prej bakri.

**Sensoret e instaluar dhe mbrojtjet e paisjeve.**

- Sensore per presionin e larte
- Sensore temperature per kompresorin
- Valvol sigurie
- Sensor temperature per ventilatoret
- Mbrojtja nga mbingarkesa.
- Mbrojtja nga mbitensioni do te realizohet me uljen e frekuences se inverterit ne 40Hz.

### **Funksioni “defrost”**

Ky funksion eshte bere i programuar, ku temperatura e nisjes se ketij funksioni do te ndryshoje ne varesi te temperatures se jashtme dhe vetem ne rastet kur qarku i kondesatorit eshte i ngrire.

### **Rrjeti i furnizimit me ajer**

#### **Tubacionet e furnizimit me ajer**

Rrjeti i furnizimit me ajer eshte llogaritur sipas medotes se renies se njejte te presionit ne tubacion dhe eshte ndertuar gjeometrikisht ne forme katrore prej llamarine celiku te zinkuar.

Spesori i llamarines ne varesi te dimensioneve te tubit eshte si me poshte:

- Per tub me brinjen e madhe - 300mm  $\delta=0.6\text{mm}$
- Per tub me brinjen e madhe - 750mm  $\delta=0.8\text{mm}$
- Per tub me brinjen e madhe - 1250mm  $\delta=1.0\text{mm}$
- Per tub me brinjen e madhe  $> 1250\text{mm}$   $\delta=1.25\text{mm}$

Lidhja e pjeseve te rrjetit deri ne madhesi 500mm eshte bere me shina ndersa per madhesi me te medha lidhja eshte bere me flanaxha.

Tubat fleksibel jane alumini me termoizolim per ajrin e trajtuar dhe alumini pa termoizolim per ventilim. Tubat me termoizolim jane prej dy shtresash alumini dhe ndermjet ketyre dy shtresave eshte vendosur termoizolimi me lesh xhami me trashesi 2.5cm.

Termoizolimi i tubave te ajrit te dergimit dhe rikthimit eshte realizuar me material izolues tip armaflex me ngjitje.

Ne te gjitha degezimet e tubit te dergimit dhe ne qafen e grilles nga ana e tubit te dergimit jane instaluar dampera volumi per rregullimin e sasise se ajrit sipas kerkesave te ambienteve.

Keto dampera jane me flanaxha dhe jane instaluar ne rrjetin e tubit. Ato jane te ndertuara prej fletesh te rrotullueshme prej celiku te zinkuar. Nje doreze plastike eshte instaluar jashte tubit per rregullimin e volumit te ajrit.

Qafa metalike e lidhjes se tubit fleksibel te griles se dergimit do te sherbeje edhe si damper volumi tip “flutur” me doreze plastike.

Damperat e zjarrit

Ne kalimet e tubave të ajrit nga një ambient zjarrdurrues tek një tjetër janë instaluar dampera zjarri. Keto janë tip perde prej materiali lamarine celiku e zinkuar dhe tip flaxhe për montim. Perdja e damperit do të mbahet e hapur, aty është instaluar një pllakë bimetalike me qendrueshmeri termike deri në 72°C.

Grilat e ajrit janë të njëjta, si ato të dergimit edhe ato të rikthimit për arsye arkitektonike. Ato janë tip “me dy rreshta dhe damper” me dy madhësi duke ruajtur një standardizim të grilave për zyrat dhe ambienteve të përbashkëta të punës, ndërsa tek bari është instaluar i njëjti tip grille por me permasa më të mëdha. Ato janë metalike dhe në varesi të kërkesave arkitektonike do të mund të lyhen me bojë elektrostatische.

Në ambientet e katit nën tokë edhe në të gjitha pikat ku kërkohet hyrje ose nxjerrje ajri nga ambienti i jashtëm janë instaluar grila “Shiu”.

### **Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe impianti i trajtimit të ujit.**

Për furnizimin e godinës me ujë sanitar është ndërtuar një depozitë prej betoni me kapacitet 60 m<sup>3</sup>, e cila mund të plotësojë nevojat e godinës për një periudhë dy javore.

Plotesimi i nevojave të godinës me ujë sanitar gjatë periudhës së shirave është menduar të bëhet me ujë të mbledhur në pusët e drenazhit. Për këtë arsye në dy pusët e drenazhit nga ana lindore e godinës janë instaluar dy elektropompa. Keto elektropompa me anë të një rrjeti hidraulik të realizuar me tuba HDPE përdoren për mbushjen e depozitës së ujit sanitar. Funksionimi i tyre është automatik.

Gjatë sezonit të thatë sasia e ujit që gjendet në katër pusët e ndërtuara do të përdoren për vaditjen e pemëve dhe të barit. Në këtë periudhë godina do të furnizohet me ujë nga jashtë me anë të një tubacioni të dedikuar për këtë qëllim.

Në ambientin mekanik të katit -1 është instaluar sistemi i klorifikimit dhe sistemi i filtrimit e zbutjes së ujit.

Sistemi i klorifikimit monitoron dhe dozon në mënyrë automatike hipoklorit në ujë të depozitës. Kjo kryhet nëpërmjet një pompe riqarkulluese. Nëpërmjet pompës riqarkulluese e cila punon me kronometër bëhet edhe ajrimi fizik i ujit të depozitës.

Një pompe shtytëse merr ujë nga depozita dhe uji pasi filtrohet dhe zbutet dërgohet në një depozitë 6m<sup>3</sup> (2 depozita metalike me kapacitet 3m<sup>3</sup> secila të lidhura në paralel). Sistemi i trajtimit të ujit përbehet nga një shkëmbyes jonik, i cili rigjenerohet me kripe (NaCl) dhe punon në mënyrë automatike.

Duhet theksuar se uji është vetëm për përdorim sanitar, nuk është i pijshëm.

Depozita e ujit mbushet në mënyrë automatike. Ajo është e kontrolluar nga sensore niveli elektronike që komandojnë pompat e furnizimit. Gjithashtu për menjanimin e emergjencave në rast difekti të sistemit elektronik të nivelit të depozitës në tubin furnizues është instaluar një galexhant mekanik me sferë, i përshtatshëm për dimensionin e tubit.

Depozita e ujit do të lidhet me stacionin e pompimit me një rrjet hidraulik të pajisur me valvola dhe kontravalvola dhe filtra për një funksionim normal të sistemit.

Sistemi i pompimit është i përbërë prej dy pompash me karakteristika Q-h 10m<sup>3</sup>/h-50m secila, të lidhura në një kolektor të përbashkët. Komandimi kryhet nga kuadri elektrik që ushqehet nga inverteri, sensorët e nevojshëm për komandim dhe valvolat dhe kondravalvolat për izolimin e rrjetit.

Rrjeti kryesor furnizues është ndërtuar prej tubi polypropilenium PPR. Rreti furnizues është instaluar në tavanin e çdo kati. Në degezimet e rrjetit dhe në pikat fundore për një selektivitet të rrjetit furnizues dhe izolim të seksioneve në rast avarie janë instaluar valvola izoluese.

Në ambjentet e çdo grupi banjosh është instaluar kuadri hidraulik. Kuadri hidraulik është metalik dhe do të përmbajë seksionin e hyrjes së ujit të ftohtë, kolektorin modular të ujit të ftohtë, kolektorin modular të ujit të ngrohtë dhe të gjitha pjesët izoluese të rrjetit.

Në çdo grup banjosh në ambjentin teknik është instaluar një ngrohës elektrik (boiler) për prodhimin e ujit të ngrohtë.

Rrjeti furnizues i pikave fundore është ndërtuar prej tubi me shumë shtresa PEX-AL-PEX me izolim termik. Çdo linjë nga kolektori deri tek pajisja do të ketë valvolë në fillim (kolektor) dhe në fund të linjës.

Për dimensionimin e rrjetit hidraulik janë marrë për bazë të dhënat e mëposhtme për çdo pajisje sanitare:

Lloji i pajisjes	Uji i ftohtë (l/s)	Uji i ngrohtë (l/s)	Presioni min (bar)
Lavaman	0,07	0,07	0,5
Lavapjate	0,15	0,15	0,5
Depozite shplarje	0.13	-	0.5
Cezem	0,15	-	0,5

Shpejtësia e rrjedhjes së ujit është si më poshtë:

Lloji i rrjetit	Shpejtësia (m/s)
Kryesor	1,5 – 1,8
Fundor	1,2

Kolektori kryesor është prej tubi të zinkuar pa tegele.

Kolektorët lokal janë ndërtuar prej pjesësh modulare gize të montuara në kaseta metalike brenda murit. Në hyrje dhe në dalje të kolektoreve janë instaluar valvola izolimi.

Tubat e rrjetit kryesorë janë prej materiali polipropileni PPR. Rrjeti do të ndërtohet me ngjitje. Të gjithë aksesoret e rrjetit janë nga i njëjti material PPR me ngjitje.

Rrjeti dytesor do të ndërtohet nga tuba PEX-AL-PEX me izolim termik. Për këto rrjete nuk lejohen bashkimet ose ngjitjet. Aksesoret e rrjetit janë montuar me rakorderi të pershtatshme për këtë sistem me shtrengim.



Lidhja e paisjeve hidrosanitare është bere me tuba fleksibel me diameter pak a shume 10mm me rakorderi.

Tubat e rrjetit kryesor do te fiksohen ne shtratin qe do te varet nga tavani me prishionire cdo 1.5m dhe me fikues hidraulik me gomine.

Tubat e rrjetit dytesor jane instaluar ne dysheme para shtreses perfundimtare.

Valvolat izoluese

Cdo hyrje dhe dalje nga kolektori kryesor është e paisur me valvol izolimi te tipit sferë (ball valve). Ne pergjithesi keto valvola jane te njejta me materialin e linjes. Valvola izolimi jane te instaluara edhe ne degezimet e rrjetit.

Minivalvola izolimi me sferë (ball valve) jane instaluar edhe ne daljet e kolektoreve lokal dhe ne pikat e lidhjes se pajisjeve hidrosanitare.

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrolle periodike ne te gjitha pajisjet e sistemit, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Frekuenca (here vit)
1	Kontroll vizual dhe riparim i lavamaneve te godines	cope	25	12
2	Kontroll vizual i WC te godines	cope	31	12
3	Kontroll vizual dhe riparim i mishelatoreve te ujit te godines	cope	35	12
4	Kontroll vizual dhe riparim i kuadrove hidraulike te godines	cope	20	12
5	Kontroll vizual dhe riparim i pishuareve te godines	cope	10	12
6	Kontroll vizual I piletave te shkarkimit te godines	cope	54	12

### **Sistemi i drenazhimit dhe shkarkimit te ujrave te bardha dhe te zeza.**

Ne kete sistem perfshihen rrjetet e tubacioneve dhe paisjet e meposhteme:

- Rrjeti i brendshem i godines per shkarkimin e ujrave te zeza dhe rrjeti i ventilimit.
- Instalimi i pajisjeve hidrosanitare.
- Rrjeti i shkarkimit te ujrave te shiut.

### Sistemi i shkarkimit

Projektimi i rrjetit të shkarkimeve të ujerave të bardha me gravitet është bërë në baze të standardit EN 12056-3, ku janë marrë të dhënat e mëposhtme:

- Sasia vjetore e reshjeve –  $0.030 \text{ l/m}^2$
- Koeficienti i rrjedhshmërisë 0.8

### Shkarkimet e ujërave të zeza

Për dimensionimin e rrjetit të ujërave të zeza është përdorur programi i llogaritjeve 4M/CALC.

Largimi i ujërave të zeza është me gravitet për katet e nivelit zero dhe +1 ndërsa për katin nën tokë largimi i ujërave të zeza kryhet me pompe.

Në katet 0 dhe +1 shkarkimet ecin në mënyrë horizontale me pas vertikalisht ato arrijnë deri tek tavanit të katin -1, dhe perseri me rrjet horizontal ato lidhen me rrjetin e jashtëm të shkarkimeve në pjesën e pasme të godinës.

Për shkak të pengesave konstruktive që hasen në grupin e banjovë të kuzhines në nivelin zero çdo grup do të zbrese individualisht në nivelin -1. Në tavanin e -1 këto zbritje bashkohen ndërmjet tyre dhe pastaj do të bashkohen me pjesën tjetër të rrjetit për të vazhduar rrugën drejt rrjetit të jashtëm. Pjerrësia e tubave horizontal është  $j = 1.5\%$ . Në çdo ndryshim drejtimi të këtij rrjeti janë instaluar tapa pastrimi.

Në katin -1 në koridorin teknik dhe mbrapa grupeve të banjovë të çdo seksioni është instaluar nga një depozitë për ujërat e zeza të këtyre grupeve. Çdo depozitë është e pajisur me çiftë pompash elektrike.

Sistemi i pompit është në gjendje të punojë në dy nivele si më poshtë:

- Niveli i poshtëm: një pompe në punë
- Niveli i sipërm: të dy pompat në punë.

### Paisjet e WC dhe Pishuaret

Paisjet hisrosanitare wc dhe pishuaret lidhen në kolektorin horizontal të seksionit të godinës për çdo kat. Për lidhjen e tyre me kolektorin horizontal përdoren aksesore rrjeti me kënde të hapura. Janë menjëherë kthesat dhe zbritjet me kënde të plotë.

### Lavamanet dhe lavapjatat

Paisjet hidrosanitare lavane dhe lavapjatat lidhen me rrjetin e shkarkimit nëpërmjet një pilete dyshemeje tip kolektor. Këto paisje nëpërmjet tubave plastik me diametër të pershtatshëm shkarkojnë në piletën e dyshemese dhe piletat shkarkojnë në kolektorin horizontal të seksionit të çdo kati.

## **Ventilimi i rrjetit të shkarkimit të ujrave të zeza**

Ventilimi i rrjetit është bërë me vazhdimin e kolonave vertikale deri tek taraca e godinës me të njëjtin dimension tubi. Në krah të këtij tubi është instaluar një tub i vecantë me të njëjtin dimension i cili shërben vetëm për ventilimin e rrjetit. Këta dy tuba bashkohen me pjerresi të kundërt në tavanin e katit +1 dhe në tavanin e katit -1.

Ventilimi i pajisjeve të largëta është bërë me tub plastik me diametër të njëjtit me kollonën vertikale me pjerresi të kundërt. Tubi i ventilimit të pajisjeve të largëta lidhet me kollonën vertikale të ajrimit. Gjithashtu nga gropat mbledhëse të katit nën tokë OST dhe CNC është instaluar një tub që do të lidhet me kollonën e ajrimit.

## **Shkarkimi i ujrave të shiut**

Shkarkimet e ujrave të shiut janë kryer me rrjedhje të lirë me gravitet. Në çdo kollonë të godinës janë instaluar tubat e shkarkimit me seksion katror. Në nivelin zero këto shkarkime do të shkarkojnë në kunetat e rrugës.

Për mbrojtjen e sifonave të taracës nga papasterite e mundëshme janë instaluar rrjeta metalike mbrojtëse.

Në nivelin -1 në fund të rampës nga të dyja seksionet do të ndërtohet një kanal për mbledhjen e ujrave të rampës. Këto ujera do të mbledhen në një pusëtë ku është instaluar një çift pompash.

## **Shkarkimi i ujrave nentokesore**

Për mbajtjen e nivelit të ujrave nentokesor në nivelin poshtë nivelit të platesë janë instaluar kater pusëta të paisura secila me një çift pompash elektrike. Komandimi i pompave është bërë me galexhantë tip dardhe.

Sistemi i pompimit është në gjendje të punojë në dy nivele si më poshtë:

- Niveli i poshtëm: një pompe në punë
- Niveli i sipërm: të dy pompat në punë.

## **Sistemi antizjarrit (zjarrfikës).**

Ky sistem është i përbërë si më poshtë:

- Depozita e ujit.
- Sistemi i pompimit.
- Rrjeti i përhershëm i hidranteve të ujit.
- Aksesoret për mbrojtjen kundër zjarrit.
- Fikesat portative të zjarrit.

## Rrjeti hidraulik i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit.

Ne godine është parashikuar instalimi i rrjetit të përhershëm hidraulik dhe hidrantet e ujit. Karakteristikat e rrjetit janë si mëposhtë:

- Prurja e çdo hidranti është 120litra/min
- Sasia e hidranteve që funksionojnë njëkohësisht 4
- Presioni i punës 2 bar
- Kohezgjatja e funksionimit në rast nevojë 120min.

Ne godine janë instaluar një numër i përshtatshëm hidrantesh dhe në pozicione të përshtatshme në mënyrë që hidrante me tub fleksibel 20m dhe rreze hedhjeje 10m të mbulojnë të gjithë sipërfaqet e godinës. Rrjeti hidraulik në përgjithësi është i dukshëm.

Dimensionimi i rrjetit me programin llogarites 4M/CALC.

Dimensionimi i rrjetit të hidranteve është:

1 HID	2 ~3 HID	4 ~6 HID	7~10 HID	17 ~25 HID.
2''	2 <sup>1/2</sup> ''	3 ''	4 ''	5 ''

Për furnizimin me ujë nga motopompat e PMNZSH (Policia e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe e Shpëtimit) në pjesën e përparme nga ana e seksionit CNC është instaluar një çift grykash DN100. Një numër i caktuar fikësash portative (tip me pluhur 6kg) janë instaluar në pozicione të tilla që largësia nga çdo pikë e godinës deri tek zjarrfikësi portativ të mos jetë më e madhe se 15m dhe largësia ndërmjet tyre të jetë 25m.

Në hyrje të godinës në katin zero është instaluar një zjarrefikës portativ 25kg.

Në të gjithë ambientet mekanike është instaluar një fikës portativ (tip me pluhur 6kg) dhe një fikës portativ (tip me CO2 6kg).

Në ambientet e serverave janë instaluar dy fikës (tip me CO2 6kg).

Për garantimin e funksionimit të sistemit zjarrfikës për një kohë 120 min duke funksionuar njëkohësisht katër hidrante me prurje 120 litra/min, në katin -1 në ambientin mekanik është instaluar një depozitë metalike me vëllim 60 m<sup>3</sup>.

Depozita është e paisur me rrjetin e mbushjes dhe rrjetin e furnizimit të hidranteve.

Mbushja e depozitës kryhet në mënyrë automatike. Depozita është e paisur me:

- Dritare kontrolli në anën e sipërme 80x80cm
- Tubin e furnizimit me elektrovalvol dhe galexhant mekanik
- Tubi i ajrimit
- Tubi i rikthimit të testimit
- Tubi i mbimbushjes në nivelin e sipërm të depozitës

- Tubi i zbrazjes së depozites.

Ne godine është instaluar grupi i pompave zjarrfikese i përbërë nga:

- Elektropompa primare
  - ✓ Pompe centrifugale
  - ✓ Motor elektrik
- Elektropompa reserve
  - ✓ Pompe centrifugale
  - ✓ Motor elektrik
- Elektropompa jockey (për mbajtjen në presion të rrjetit zjarrfikës).
  - ✓ Pompe centrifugale
  - ✓ Motor elektrik
- Depozite me membrane
- Kuadri i fuqisë dhe i automatikës.

Kuadri elektrik do të ketë të gjitha pajisjet e nevojshme dhe është i montuar në fabrikë.

- Sensoret e komandimit dhe pajisjet e izolimit.

Minimumi i sensoreve që do të monitorojë sistemin e pompimit dhe pajisjet e izolimit janë:

- ✓ Tre sensore diferencial presioni për kontrollin dhe funksionimin e sistemit të pompimit
- ✓ Tre matës presioni me valvol izolimi
- ✓ Tre kundervalvola dhe tre valvola nga pompa në drejtim të kolektorit të dërgimit
- ✓ Tre valvola nga kolektori i thithjes në drejtim të pompave

Tubat e rrjetit të sistemit zjarrfikës janë prej çeliku të zinkuar.

Tubat janë me tegel sipas DIN 2440 (Medium-weight threaded steel tubes) dhe do të lidhen me fileto. Rrjeti është i ndërtuar për të funksionuar në presion nominal 16 bar.

Rrjeti zjarrfikës i është nënshtruar testit hidraulik me presion 18 bar për 24 orë.

#### **Metoda dhe aksesoret e fiksimit të tubave.**

Instalimi i tubave të sistemit të zjarrit është bërë sipas EN 10779 kapitulli 7.2. Sistemi janë fiksuar me aksesoret kollaro tip “dardhe” me prixhionier të montuar në strukturën e betonit të tavanit.

Në tabelën e mëposhtme tregohet seksioni minimal i aksesorit të mbështetjes, trashësia e kollares dhe prixhionieri.

DN	Seksioni minimal neto i mbështetjes mm <sup>2</sup>	Spessori minimal i mbështetjes mm	Dimensioni i prixhionierit mm
Deri në 50	15	2.5	M8
nga DN 50 deri në DN 100	25	2.5	M10
nga DN 100 deri në DN 150	35	2.5	M12
nga DN 150 deri në DN 200	65	2.5	M16

nga DN 200 deri ne DN 250	75	2.5	M20
Per mbeshtetes me kollaro : 1.5mm			

Fikesi portativ eshte bombule prej metali cilesie EDDQ me presion prove 35 bar. Bombulat kane vetem nje hapje me buze te filetuesheme ne te cilen lidhet valvola e leshimit, doreza dhe manometri i kontrollit te presionit te brendshem, me simbole dhe ngjyra per kontroll te menjehershem. Fikesat pluhur jane te pershtatshe per fikjen e zjareve A.B.C. me tregimin e pershtatshem.

### **Fikes portative CO2**

Fikesi portativ i dioksidit te karbonit eshte ne perputhje me kerkesat NHS 31-1972, 32-1972, 33-1972.

Pervec kesaj fikesat portative CO2 kane:

- ✓ Valvol leshimi
- ✓ Doreze
- ✓ Sistemin e varjes
- ✓ Kollare per varje

Te gjithë fikesat jane te testuar sipas NHS dhe jane te pajisura me tabelen ku jane te shkruajtura karakteristika dhe metoda e perdorimit.

### **Sistemi i vezhgimit dhe sinjalizimit te zjarrit**

Ne godine eshte parashikuar instalimi i sistemit te vezhgimit dhe sinjalizimit te zjarrit ne te gjitha ambientet e godines sic tregohet edhe ne vizatimet perkatese. Per kete eshte instaluar kuadri i vezhgimit i adresueshem me kater qarqe te mbyllura vezhgimi ( nje qark i mbyllur per kat ). Vezhgimi i vatrave te zjarrit realizohet me instalimin e sensoreve te tymit.

### **Organizimi i sistemit**

Sistemi eshte i perbere nga:

Kuadri i vezhgimit dhe lajmerimit te zjarrit qe do te mbledhe informacionin nga pajisjet periferike (sensore, butona, module monitorimi etj).

Sensore termike lineare te paadresueshem.

Sensore te adresueshem tymi te cilet lidhen ne qarkun e mbyllur dhe do te instalohen ne ambiente te ndryshme sic tregohen ne vizatim.

Lajmerues te adresueshem te cilet lidhen ne qarkun e mbyllur dhe do te instalohen kryesisht ne dalje sic tregohen ne vizatime.

Njesite e lajmerimit optiko-akustik qe do te shoqerojne dhe do te komandohen nga butonat perkates dhe ushqim nga kuadri i sinjalizimit te zjarrit.

Kabllimet e nevojeshem qe garantojne transmetimin e sinjaleve impulsive nga njesite periferike ne drejtim te kuadrit te sinjalizimit te zjarrit.

Kuadri i sinjalizimit te zjarrit bashke me sistemin e ushqimit rezerve (baterite) eshte instaluar ne katin perdhe tek zyra e sigurise seksioni OST. Kuadri i sinjalizimit te zjarrit eshte i adresueshem me tre zona (qark i mbyllur), nje zone per cdo kat.

Ne rastin e nje vatre zjarri ajo vëzhgohet nga njesia periferike e vëzhgimit te zjarrit dhe tregimet e meposhteme behen menjehere ne kuader:

- Nje tregues optik alarmi ndizet dhe fiket ne kuader
- Nje buzzer lokal ne kuader do te sinjalizojë gjendjen e alarmit duke mos lejuar procedure “silence”
- Ekran i kuadrit tregon te gjidha te dhenat per alarmin dhe ambientin ku ka ndodhur.
- Mesazhet e ndryshimit te gjendjes tregohen ne ekran ose printohen.

Nga ana tjeter kuadri ne menyre te menjehereshem fillon procedurat e aktivizimit te sistemeve te lajmerimit optiko – akustik.

Ne raste te nje gjendje “difekt” ne paisjet periferike ose ne rrjetin e transmetimit (zone) kuadri ka tregimet e meposhteme:

- Sinjalizimi optik i gjendjes “fault” aktivizohet
- Sinjalizimi akustik (buzzer) i ndryshem nga sinjai akustik i gjendjes “alarm” me mundesine e procedures “silence” aktivizohet
- tregimin e tipit te difektit ne kuader.

Kuadri eshte i pajisur me dalje rele per sinjalizimin dhe aktivizimin e sistemit te lajmerimit publik dhe aktivizimin e paisjes telefonike per komunikim me numra te jashtem dhe policine e mbrojtjes dhe te shpetimit nga zjarri.

Programimi i menyres se lajmerimit te zjarrit behet ne bashkepunim me perdoruesin e godines.

Ne ambientet elektrike ne te dy katet te sipërme ku do te kemi instalimin e kanalines metalike ne dyshemene e ngritur do instalohet sensori optik. Per monitorimin e ketij sensori dhe integrimin e tyre ne kuadrin e vëzhgimit dhe lajmerimit te zjarrit do te instalohen ne qarkun e mbyllur tavanor. Per instalimin e sensoreve te zjarrit jane marre per baze funksionimi i tyre dhe pastaj kerkesat arkitektonike. Sensoret e instaluar jane :

- Sensor optik tymi
- Sensor termik
- Sensor termike lineare.

### **Sensoret optike te tymit**

Sensoret optike do te jene te adresueshem dhe jane instaluar poshte tavanit te varur ne te gjithë godinen me perjashtim te ambienteve te barit.

Sensoret optike te tymit kane nje zone mbulimi 50-80m<sup>2</sup>. Largesia ndermjet dy sensoreve eshte jo me e madhe se 10 m ndersa largesia nga muret dhe pengesat vertikale jo me afer se 3.5m. Sensoret instalohen ne nje largesi jo me te vogel se 1m nga te gjitha paisjet dhe aparaturat e fryrjes se ajrit. Sensoret e zjarrit jane me module izolimi te i korporuar per te dhene mundesine e leximit te dyanshem te kuadrit ne rastin e difektit kabllor.

### **Sensoret termike**

Sensoret termike jane instaluar ne ambientin e barit poshte tavanit te varur.

Sensoret termike kanë nje zone mbulimi 100m<sup>2</sup>. Largesia ndermjet dy sensoreve eshte jo me e madhe se 13m ndersa largesia nga muret dhe pengesat vertikale jo me afer se 6m. Sensoret instalohen ne nje largesi jo me te vogel se 1m nga te gjitha paisjet dhe aparaturat e fryrjes se ajrit. Sinjalizimi manual i zjarrit do te instalohet ne te gjitha godinen.

Per sinjalizimin manual te zjarrit ne daljet e emergjences te cdo kati jane instaluar sinjalizues manual (buton) me xham ne meyre qe largesia maksimale per te aritur tek pulsanti gjate daljes se emergjences te mos jete me e madhe se 30m. Me shtypjen e butonit, behet ne menyre automatike nga kuadri pozicionimi i sakte i ambientit nga ka ardhur sinjalizimi. Butonat manuale te sinjalizimit te zjarrit jane te adresueshem dhe lidhen ne qark te mbyllur.

Sinjalizuesi optiko akustik eshte ne te njejtin pozicion dhe komandohet prej sinjalizuesit manual (buton). Ai furnizohet nga kuadri i sinjalizimit te zjarrit.

### **Rrjeti kabllor**

Rrjeti kabllor horizontal i sistemit te sinjalizimit te zjarrit eshte ndertuar prej kablli sinjali 2x0.8mm<sup>2</sup> i cili do te instalohet ne tuba plastike rigide brenda tavanit te varur, ndersa rrjeti vertikal do te instalohet ne kanalinen e rymave te dobeta te instaluara ne menyre vertikale ne ambjertet elektrike.

Duhet te vendoset centrali qendor i monitorimit dhe dedektimit te tymit ( perpara se te vendoset dhe konfigurohet duhet te realizohet tarimi i te gjitha sensoreve te vendosur ne godine ( 400 sensore ).

### **Sistemi elektrik i ndricimit dhe i fuqise.**

Ne sistemin e elektrik perfshihen nensistemet dhe paisjet e meposhteme:

- Furnizimi me energji elektrike i godines, me tension te mesem 20 kV nga nenstacioni “Tirana 2”.
- Celat e komandimit te linjes dhe transformatorit per tensionin 20 kV
- Transformoret e fuqise 20/0.4 kV
- Kuadri kryesor i tensionit te ulet
- Gjeneratori i emergjences
- Sistemi i UPS-ve
- Rrjeti shperndares dhe furnizues me tension te ulet
- Kuadrot lokal te tensionit te ulet
- Nricimi i brendshem
- Ndricimi i jashtem.

### **Furnizimi me energji i godines**

Furnizimi i godines eshte bere nga nenstacioni “Tirana 2” me dy feedera 20kV. Vlerat elektrike te rrjeteve jane si meposhte:



### **Tensioni i mesem**

- Tensioni nominal – 20kV
- Tensioni maksimal – 24kV
- Numri i fazave - 3
- Frekuenca – 50HZ

### **Tensioni i ulet**

- Tensioni nominal – 0.4/0.23kV
- Numri i fazave - 3+N
- Frekuenca – 50Hz

Kabllo e furnizimit me energji

Furnizimi i godines eshte bere nga nenstacioni “Tirana 2” nga ana e tensionit te mesem 20kV ne celat A4 she B4.

Kablli i linjes eshte Alumini 3x1x185/25mm<sup>2</sup> me izolim XLPE/PVC dhe me tension nominal 12/20kV.

Ne pjesen e linjes nga nenstacioni deri tek rrethimi i nenstacionit kablli eshte shtrire ne kanaleten egzistuese te nenstacionit. Per hyrjen e kablllove ne godinen e nenstacionit jane perdorur hyrjet egzistuese te nenstacionit.

Kalimi i kanalit i cili ndodhet ne rrethimin e nenstacionit kryhet me ndihmen e tubave metalike.

Ne pjesen e linjes nga rrethimi i nenstacionit “Tirana 2” deri tek rrethimi i godines kabllot e linjave jane instaluar ne tuba elektrike HDPE. Ne distance cdo 24m jane ndertuar puseta kalimtare per shtrimin e kabllit. Tubat jane te vendosur ne kanal.

Profili i kanalit eshte:

- Gjeresia 60cm
- Thellesia e kanalit 110cm

Ne pjesen e brendeshme te oborit te godines kablli eshte instaluar ne tuba HDPE nga rrethimi deri ne hyrje te godines ne interkapet.

Ne inerkapet deri tek celat e tensionit te mesem kabllot jane instaluar ne pasarela metalike.

Per menjanimin e kalimit te ujit ne godine nga pika e hyrjes se kablllove jane mare masa hidroizoluese.

### **Panelet e tensionit te mesem**

Celat e tensionit te mesem jane instaluar ne katin nentoke. Ne dyshemene e ambientit te tensionit te mesem jane ndertuar kanale elektrike te cilat jane mbuluar me kapak metalik duke lejuar hyrjen e kablllove te tensionit te mesem nga ana e poshteme e celes.

Sic u permend edhe me siper, godina eshte furnizuar me dy fidera 20kV. Keto dy fidera jane lidhur celat hyrese me aksesore te pershtatshem (koka kablli te brendeshme) ,si per tensionin ashtu edhe per dimensionin e kabllit.

Ne katin nentoke ne ambientin elektrik te tensionit te mesem jane instaluar dy grupe celash ( per cdo fider ) qe funksionojne ne menyre te pavarur nga njera-tjetra.

Secili grup eshte i perbere nga:

- Cela e hyrjes e pajisur me ndares ngarkese SF6 me tre pozicione.
- Cela mbrojtese e transformatorit me:
  - ✓ Celes SF6
  - ✓ Ndares ngarkese me tre pozicione
  - ✓ Rele kontrolli dhe komandimi

Ne gjendje normale te dyja grupet e cleave jane te kycura (nen tension)

### **Transformatorët**

Ne godine jane instaluar dy transformatore te thate 800 kVA. Keta transformatore jane rezerve te njeri tjetrit dhe asnje here nuk do te punojne ne parallel. Secili transformatore furnizohet nga cela mbrojtese e fiderit perkates me kabell 3x1x185/16mm<sup>2</sup> me izolim XLPE/PVC dhe me tension nominal 12/20kV qe do te lidhet me aksesore te pershtashem per tensionin dhe dimensionin e kabllit (koka kablli). Kablli do te instalohet ne kanaline metalike.

Per zvogelimin e humbjeve ne regjimin pa ngarkese jane instaluar blloqe kondesatoresh te perhershem.

Transformatorët jane te paisur me sonda temperature tip Pt100. Ne kuadrin kryesor te tensionit te ulet do te instalohet dy paisje elektronike per monitorimin e sondave te temperatures. Ne varesi te temperatures se sondave paisja elektronike kryen:

- Fillimin e ventilimit te sforcuar te ambientit (FAN)
- Sinjalizim per temperature te larte ne transformator (ALARM 1).
- Ckycjen e automatit te tensionit te ulet ne rast se tempera qofte edhe e njeres prej peshjtellave te jete me e madhe se e lejuara (TRIP)

Per ajrimin e ambientit te transformatoreve eshte instaluar nje ventilator centrifugal. Per te patur nje cikël te mire te qarkullimit te ajrit dera e transformatorit eshte me grila ajrimi ne menyre te tille qe ajri nga ambjenti i brendshem nepermjet grilave te deres te qarkulloje nga poshte larte duke krijuar nje ftohje te pershtatshme te transformatoreve.

### **Kuadri kryesor i tensionit te ulet.**

Kuadri kryesor i tensionit te ulet eshte instaluar ne katin nentoke ne ambientin elektrik prane ambientit te transformatoreve. Kuadri kryesore eshte i tipit modular me instalim ne toke dhe i hapur. Secili modul do te jete i permasave te standardizuara 800x800x2000mm. Lidhja e transformatoreve me kuadrin kryesor eshte bere me kablllo PVC/PVC 0,6/1kV. Kabllot jane instaluar ne kanaline metalike te montuar ne tavan.

Nga ana elektrike rrjeti Transformator – Kuader Kryesor Tensioni i Ulet eshte i tipit TN-S.

Nga ana e burimeve furnizuese KKTU eshte i ndare ne dy seksione:

- Seksioni “normal”, furnizim vetem nga linjat e nenstacionit.

- Seksioni i “emergjences”, furnizim nga transformatorët dhe në rast avarie të të dy linjave nga nënstacioni, si burim energjie për këto seksione është gjeneratori i emergjences.

Kompozimi dhe konstruksioni i KKTU është bërë në varesë të burimeve të energjisë elektrike dhe konsumatoreve që do të furnizohen nga ky kuadër. Duke u nisur nga këto të dhëna kuadri do të kompozohet si mëposhtë:

- **Seksioni normal**

- ✓ Dy automatet në karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 2500A 4P, të motorizuar, izolim (me zhvendosje mekanike) nga zbarat e tensionit dhe heqje totale nga kuadri në rast nevojë (withdrawable) për furnizimin nga transformatorët. Këta automate janë të pajisur me të gjithë aksesoret e nevojshëm për realizimin e funksioneve të mesipërme si dhe instalimin e multimetrave pas çdo automati. Të dy automatet janë me bllokim mekanik “interlock” në të dyja funksionet automatik dhe manual.
- ✓ Blloku i kondesatoreve për përmirësimin automatik të  $\cos\phi$ . Blloku i kondesatoreve është me 10 shkallë me 5kVAr secili bllok. Komandimi do të kryhet në mënyrë automatike
- ✓ Dy automatet në karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) për furnizimin e kuadrove të kondicionimit.
- ✓ Dy automatet në karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 800A 4P, të motorizuar, izolim (me zhvendosje mekanike) nga zbarat e tensionit dhe heqje totale nga kuadri në rast nevojë (withdrawable) për furnizimin e seksionit të “emergjences”. Këta automate janë të pajisur me të gjithë aksesoret e nevojshëm për realizimin e funksioneve të mesipërme si dhe instalimin e multimetrave pas çdo automati. Të dy automatet janë me bllokim mekanik “interlock” në të dyja funksionet automatik dhe manual.

### **Seksioni i emergjences**

- ✓ Automatet me karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) të dimensioneve të ndryshme 4P tip “fix” për furnizimin e konsumatoreve të ndryshëm.
- ✓ Kater automatet në karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 200A 4P tip “fix” për furnizimin e dy UPS 120kVA.
- ✓ Kater automatet në karkase modulare (modul case circuit breaker MCCB) 200A 4P tip “fix” për furnizimin e dy UPS 20kVA.

### **Gjeneratori i emergjences**

Për mos ndërprerje të funksionimit të godinës në rast avarie të dy fiderave furnizues nga nënstacioni do të instalohet një gjenerator emergjence. Në bazë të llogaritjeve të kryera nevojat e godinës në këto rast kërkojnë një gjenerator me fuqi LTP 440 kVA që përdoret si burim i dytë energjie për furnizimin e seksionit të “emergjences”. Ai është instaluar jashtë godinës nga ana jugperendimore në një bazament betoni të niveluar. Gjeneratori është i tipit të mbyllur.

Per funksionim te gjeneratorit per 24ore eshte inkorporuar nje depozite nafte.

Per hyrjen ne godine te kabllave furnizues nga gjeneratori eshte ndjekur e njejta metodike si edhe per hyrjen e kabllave te tensionit te mesem. Nga ana e gjeneratorit dhe nga ana e godines ne piken e hyrjes jane ndertuar dy puseta. Keto dy puseta jane lidhur me tuba metalike  $\Phi 200$  ne te cilat do te futet kablli furnizues tip PVC/PVC 0,6/1kV. Nga hyrja deri tek kuadri kryesor i tensionit te ulet kabllot jane te montuara ne kanaline metalike.

### **UPS**

Per furnizimin e paisjeve te vecanta elektronike, te vendeve te punes dhe paisjeve qe nuk lejohet nderprerja e menjehereshme e energjise (sistemet e sigurise) ne godine jane instaluar paisjet e furnizimit pa nderprerje te energjise UPS, burimi i energjise te “privilegjuar”. Burimi i “privelegjuar” do te furnizoje paisjet e siperpermendura ne intervalin kohor nga moment i nderprerjes se energjise deri ne ndezjen e gjeneratorit dhe ne rast avarie te gjeneratorit. Per nevojat e godines do te instalohen dy UPS 120kVA secili, te cilet jane rezerve e njeri - tjetrit. Te dy UPS lidhen me nje grup te perbashket baterish qe do te garantojne nje kohezgjatje furnizimi 60min.

Te dy UPS jane te montuar ne katin nentoke tek ambienti i “UPS”. Per nevojat ftohese te ambientit dhe per nje funksionim normal te paisjeve eshte instaluar nje sistem kondicionimi.

Per pajisjet elektronike te sigurise se larte, si serverat e sistemit SCADA, tlc, telemetering dhe IT, qe kerkojne nje furnizim te dyfishte eshte instaluar nje UPS i trete i cili do te furnizoje vetem keto paisje dhe sherben si burim energjie “sigurie”. UPS i burimit te “sigurise” eshte 20kVA me nje kohezgjatje 60min. Ai eshte instaluar ne katin nentoke, ne te njejtin ambient me dy UPS-te e tjera. Secili UPS furnizohet me dy linja nga seksioni i gjeneratorit.

Per nevojat e shperndarjes se fuqise te UPS-ve ne ambientet e UPS-ve eshte instaluar nje kuader elektrik me dy seksione:

- Kuadri i privilegjuar UPS 1ose UPS 2
- Kuadri i serverave.

### **Rrjeti i shperndarjes se tensionit te ulet.**

Sic u pershkrua edhe me siper ne godine jane instaluar:

- Rrjeti normal i furnizimit (furnizim nga fiderat e nenstacionit)
- Rrjeti i emergjences (furnizim nga gjeneratori ne rast difekti te dy fiderave te nenstacionit)
- Rrjeti privilegjuar (furnizimi nga UPS ne intervalin e kohes qe nevojitet per ndezjen e gjeneratorit ose ne rast avarie te dy fiderave te nenstacionit dhe te gjeneratorit)
- Rrjeti i sigurise (furnizimi nga UPS per serverat ne rast avarie te fiderave te nenstacionit, te gjeneratorit dhe pas nderprerjes se energjise nga rreti i privilegjuar).

Rrjeti i shperndarjes eshte ndertuar me kabell tensioni te ulet me izolacion dhe veshje PVC/PVC me izolim 0.6/1 kV. Keto kabllot jane instaluar ne kanalina metalike kryesisht ne rrjetin horizontal dhe ne shkalle metalike ne rrjetin vertikal.

### **Kanalinat dhe shkallet metalike.**

Kanalinat metalike shërbejnë kryesisht për rrjetin horizontal të shpërndarjes së tensionit të ulet. Ato janë të tipit të brimezuara të zinkuara ose tip rrjete. Për ndertimin e rrjetit të kanalave janë përdorur aksesore të kompanisë prodhuese. Rrjeti i kanalave është dimensionuar në varesi të kabllove që do të instalohen në të.

Kanalinat nën nga kuadri kryesor i tensionit të ulet hyjnë në koridorin teknik të katit nën tokë ku degezohen. Një dege e kanalave drejtohet në drejtim të ambienteve teknike, pompat e zjarrit, ndërsa dega tjetër vazhdon në drejtim të laboratoreve të OST, duke lënë degezimet për ngjitjet vertikale në ambientet elektrike.

Instalimi i kanalave është bërë me prirje të fiksuar në tavan dhe me profile metalike mbështetës. Në kalimet e ambienteve zjarreduruese kalimet e kanalave janë mbyllur me materiale zjarreduruese.

Shkallet metalike do të instalohen në rrjetin verikal. Kryesisht ky rrjet ndodhet në ambientet elektrike. Montimi i shkallës është bërë me profile “C” hekuri që do të shërbejnë edhe si distancator.

#### **Kabllo të tensionit të ulet.**

Kabllo të sistemit të shpërndarjes janë kabllo me izolim dhe veshje PVC, me tension izolimi 0.6/1kV. Kabllo do të instalohen në kanalinat horizontale dhe shkallet vertikale. Ato janë të etiketuara në fillim (kuadrin kryesor) dhe në fund të gjatësisë (kuadri lokal).

Për dimensionimin e madhësisë së kabllove janë marrë të dhënat e mëposhtme:

- Temperatura e punës 35°C
- Menyra e instalimit “F ose E”
- Kabllo do të instalohen në një shtresë me kontakt midis tyre

#### **Kuadrot e kateve dhe kuadrot e mekanikës**

Pas sistemit të kabllove në kanalinat ato janë fiksuar me lidhëse plastike.

#### **Kuadrot e kateve.**

Kuadrot e kateve do të instalohen në ambiente elektrike të kateve perkatëse. Duke u nisur nga llojet e burimeve kuadrot e kateve janë me seksionet e mëposhtme:

- Kuadri katit në tokë seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i emergjencës (furnizim nga seksioni GEN I KKTU)
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” (furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2)
- Kuadri katit në tokë seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i emergjencës (furnizim nga seksioni GEN I KKTU)
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” (furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2)
- Kuadri katit përdhe seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i emergjencës (furnizim nga seksioni GEN I KKTU)
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” (furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2)
  - ✓ Seksioni i “sigurisë” (furnizim nga kuadri I UPS3)
- Kuadri katit përdhe seksioni OST:

- ✓ Seksioni i emergjences ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
- ✓ Seksioni i “privilegjuare” ( furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2 )
- ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim nga kuadri i UPS3 )
- Kuadri katit pare seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i emergjences ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri i UPS1 ose UPS2 )
- Kuadri katit pare seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i emergjences ( furnizim nga seksioni GEN I KKTU )
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim nga kuadri I UPS1 ose UPS2 )

### **Kuadrot e mekanikes**

- Kondicionimi seksioni CNC
  - ✓ Seksioni normal ( furnizim nga seksioni i nenstacionit )
  - ✓ Seksioni i “emergjences” furnizim nga seksioni GEN I KKTU)
- Kondicionimi seksioni OST
  - ✓ Seksioni normal ( furnizim nga seksioni I nenstacionit )
  - ✓ Seksioni i “emergjences” (furnizim nga seksioni GEN I KKTU)
- MKZ.
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim nga seksioni GEN KKTU )
- Pompat e ujit, drenazhit dhe ujerave te zeza
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim nga seksioni GEN KKTU )

Kuadrot elektrike jane te gjithë metalike. Ne vartesi te madhësisë se tyre është bere edhe instalimi. Kuadrot e medhënj do te instalohen ne toke ndërsa kuadrot e vegjel do te instalohen te varur. Përvec kuadrove te siperpermendur, ne ambiente te vecanta jane instaluar kuadro elektrike per pavaresi nga kuadrot e kateve si dhe per kerkesa te vecanta te ambienteve. Keto ambiente pershkruhen si me poshte:

- Kuadri i SCADA katit perdhe seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuare” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri katit perdhe seksioni CNC )
  - ✓ Seksioni “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni CNC)
- Kuadri i TLC katit perdhe seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri i katit perdhe seksioni CNC )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni i UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni CNC )
- Kuadri i TM katit perdhe seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST)
- Kuadri i IT katit perdhe seksioni OST:

- ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri katit perdhe seksioni OST )
- ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
- Kuadri i 220/48V katit nentoke ambjenti 3BE seksioni CNC:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
- Kuadri i 220/48V katit nentoke ambjenti 12LTF seksioni OST:
  - ✓ Seksioni i “privilegjuar” ( furnizim seksioni UPS1 ose UPS2 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
  - ✓ Seksioni i “sigurise” ( furnizim seksioni i UPS3 kuadri i katit perdhe seksioni OST )
- Kuadri i BARIT katit perdhe OST:
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim seksioni i GEN KKTU )
- Kuadri i ndricimit te jashte katit nentoke ambjenti i KKTU:
  - ✓ Seksioni i “emergjences” ( furnizim seksioni i GEN KKTU )

### **Rrjeti furnizues i TU (ndricim – fuqi motorike)**

Rrjeti furnizues i tensionit te ulet sherben per furnizimn me energji te ndricimit, vendeve te punes dhe fuqive te ndryshme motorike te instaluara ne godine.

#### *Ndricimi*

Ndricimi i godines eshte konceptuar ne perputhje me kerkesat arkitektonike dhe kerkesat per sasine e ndricimit ne godine sipas ambienteve.

- Zyrat 500lux
- Koridore dhe shkalle 200lux
- Ambjentet sanitare 200lux
- Arkivet 300lux
- Magazinat 200lux
- Ambjentet mekanike 200lux

Rrjeti i ndricimit eshte ndertuar prej kablli me izolim dhe veshje PVC/PVC me izolacion 400/750V. Per shperndarjen e linjave te ndricimit ne koridor dhe nga ana e tavanit te hapshem eshte instaluar nje kanaline rrjete. Per furnizimin e linjave nga kanalina deri tek ndricuesi i pare, I linja e kabllit te ndricimit eshte instaluar drejteperdrejt ne tavan me aksesoret e pershtatshem per fiksim. Ne abientet mekanike dhe elektrike instalimi i ndricimit eshte i jashtem. Per realizimin e mbrojtjes mekanike te kabllove ato jane kaluar ne tub rigid PVC.

Per shperndarje e te njejtës linje ne drejtime te ndryshem jane perdorur kuti shperndares PVC 10x10cm.

Pajisjet e komandimit janë instaluar brenda murit, për arsye sigurie është instaluar në tub fleksibel në pjesën e linjës brenda murit. Lartësia e montimit të pajisjeve të komandimit të ndricimit është 1.1m.

Ndricimi furnizohet nga kuadri i katit sipas seksionit të godinës. Furnizimi është bërë nga seksioni i “emergjencës”.

#### **Ambientet e perbashketa të punës**

Për ndricimin e ambienteve të hapura të punës janë përdorur ndicues linear me grille alumini. Ato janë të vazhdueshme në përputhje me kërkesat arkitektonike. Në këto ambiente do të instalohen dy rreshta ndricuesish të vazhdueshme me fuqi 2x28W.

Ndricuesit janë me llampe floureshente me ndricim të ngrohtë.

Komandimi i ndricimit për këto zona është bërë me pulsant që janë instaluar lokalisht në hyrje dhe në dalje të ambienteve. Në krahe të pulsanteve janë instaluar edhe reostat për ndryshimin e fuqisë së ndricimit.

#### **Zyrat dhe sallat e mbledhjes.**

Në zyrat e mbyllura dhe sallat e mbledhjeve janë instaluar ndricues të pershtatshëm për tavan të varur 60x60cm, 4x14W.

Ndricuesit e këtyre ambienteve janë tip me grille alumini. Llambat e ndricuesave janë floureshent me ndricim të ngrohtë.

Komandimi i ndricimit për këto ambiente bëhet me cele.

#### **Koridoret.**

Përzgjedhja e ndricimit të koridoreve për katin për dhe katin e parë është bërë në përputhje me kërkesat arkitektonike.

Ndricimi i këtyre koridoreve është i fshehtë me ndicim indirekt. Në pjesën e thyer të tavanit të varur do të instalohen llampa floureshente 14/28/35W.

Komandimi i këtij ndricimi është bërë në të njëjtat pika si në ambientet e perbashketa të punës me buton.

Në këto koridore në mes të gjërësive së tavanit të varur dhe në mes të gjatësive së dy kllonave është instaluar një ndricues led 1x15W. Ky ndricues do të furnizohet nga seksioni i UPS 1&2 dhe do të shërbejë si ndricues emergjence, ndricuesi nuk do të ketë komandim dhe do të përdoret edhe si ndricim natë.

Në katin nën tokë në pjesën e koridorit me tavan të varur ndricuesit janë me fuqi 2x26W. Në koridoret pa tavan të varur ndricuesit janë industrial 1x58W.

#### **Shkallet**

Ndricimi i shkalleve është bërë me ndricues tip led në shkallet qendrore dhe të pershtatshëm për ndricim të jashtëm.

Furnizimi ndricueseve të shkallës është bërë nga seksioni i UPS 1&2 dhe janë të pakomandueshëm.

#### **Ambientet sanitare.**

Ndricimi i ambienteve sanitare është bërë me ndricues led 8W për parabanjot – lavaman dhe led 8W për ambientin e WC.



Ne parabanjo te cdo grupi banjosh do te instalohet i njejt ndricues led 8W me furnizim nga seksioni i UPS 1&2.

Komandimi lokal i ndricimit eshte bere me celes lokal.

### **Arkivat**

Ndricimi i arkivave eshte bere me ndricues 4x18W me llampe floureshente me ndricim te ngrohte. Ne keto ambiente eshte parashikuar furnizimi i ndricimit nga seksioni UPS1&2.

Komandimi i ndricimit ne keto ambiente eshte bere me buton.

### **Magazinat**

Ndricimi i magazinave eshte bere ne varesi te tavanit te varur, me ndricues 4x18W ne rast se do te kemi tavan te varur dhe ndricues industrial nese ambienti nuk ka tavan te varur.

Komandimi i ndricimit eshte bere me celesa lokal.

### **Ambientet mekanike.**

Ndricimi i ambienteve mekanike eshte bere me ndricues induatrial IP 65 1x49W me llampe floureshemte te ngrohte.

Komandimi i ndricimit ne keto ambiente eshte bere me celes lokal.

### **Ndricimi i emergjences**

Ndricimi i ergjences eshte i ndare ne:

- Ndricimi i emergjences
- Ndricimi i sinjalistikes se daljeve te emergjences.

Ndricimi i emergjences sic e pershkruam edhe me larte eshte bere ne vartesi te ambientit.

Ndricimi i sinjalistikes se daljeve te emergjences eshte bere me instalimin e ndricuesave 8W ne daljet e emergjences dhe ne ndryshimin e drejtimit horizontal dhe vertical me sinjalistiken perkatese.

### **Prizat e vendeve te punes dhe te sherbimit.**

Rrjeti i prizave te vendeve te punes dhe te sherbimit eshte ndertuar prej kablli me izolim dhe veshje PVC/PVC me izolacion 400/750V.

Shperndarja e linjave te prizave eshte bere poshte dyshemese se ngritur ne koridor nepermjet kanalines rrjetit ku jane instaluar. Dimensionimi i kanalines eshte ne varesi te sasise se kablllove qe jane instaluar ne kanaline. Pjesa e linjave furnizuese nga kanalina rrjete deri tek prize furnizuese eshte bere me guaino ose tub fleksibel. Ne abientet mekanike dhe elektrike instalimi i ndricimit eshte i jashtem. Per realizimin e mbrojtjes mekanike te kablllove ato eshte kaluar ne tub rigid PVC. Per shperndarjen e te njejt linje ne drejtime te ndryshem jane perdorur kuti shperndares PVC 10x10cm.

Per cdo vend pune jane parashikuar dy priza me ngjyre te bardhe qe do te furnizohen nga seksioni “emergjences” dhe dy priza me ngjyre te kuqe qe do te furnizohen nga seksioni i “privilegjuar” Ne varesi te ambientit eshte bere edhe menyra e instalimit.

### **Ambientet e perbashketa te punes**

Ne ambientin e perbashket te punes prizat e vendeve te punes jane instaluar ne nje kuti dysHEMEJE te pershtatshme per dysHEME te ngritur. Madhesia e kutise eshte e tille qe mund te instalohen kater prize shuko dy moduleshe dhe kater priza RJ45 nje moduleshe.

#### **Zyrat dhe sallat e mbledhjes.**

Ne zyrat e mbyllura jane instaluar priza per cdo vend pune. Instalimi eshte bere ne varesi te pozicionit te zyres. Ne parim prizat e vendeve te punes jane instaluar ne mure ne lartesi 40cm nga dysHEMEJA. Ne rast se kjo menyre instalimi eshte e pamundur prizat e vendeve te punes jane instaluar ne kuti dysHEMEJE si tek ambientet e perbashketa te punes. Per nevojat e pastrimit te zyrave ne drejtim me celesin e komandimit te ndricimit dhe ne lartesi 40cm nga dysHEMEJA eshte instaluar nje prize sherbimi ne njejten linje me vendet e punes dhe furnizim nga seksioni i “emergjences”.

Ne sallat e mbledhjes jane instaluar nje kuti dysHEMEJE me prizat si ne vendet e punes.

#### **Koridoret.**

Ne largesi cdo 20m dhe lartesi 40cm nga dysHEMEJA jane instaluar priza sherbimi (pastrami). Keto priza furnizohen nga seksioni i “emergjences” dhe jane te bardha.

Ne abientet e koridorit ku jane pashikuar fotokopjet dhe printerat jane instaluar ne lartesi 120cm nga dysHEMEJA prizz schuko. Keto priza do te furnizohen nga seksioni i “emergjences”.

#### **Ambientet sanitare.**

Ne ambientet sanitare do te parashikohet linja furnizuese e drejteperdrejte nga kuadri elektrik seksioni i “emergjences” tek boileret elektrike dhe tharesat elektrik te duareve.

#### **Arkivat**

Ne keto ambiente jane parashikuar instalimi i prizave te sherbimit me furnizim nga seksioni i “emergjences”.

#### **Magazinat**

Ne keto ambiente jane parashikuar instalimi i prizave te sherbimit me furnizim nga seksioni i “emergjences”.

#### **Ambientet mekanike.**

Ne krahe te pikes se komandimit te ndricimit ne ambjentet mekanike dhe elektrike jane instaluar nje prize e jashteme 220V dhe nje prize 3Ph/N/PE 400V.

Furnizimi i ketyre prizave eshte bere nga seksioni i “emergjences”.

#### **Fuqite motorike**

#### **Pajisjet e kondicionimit VRF.**

Pajisjet e kondicionimit te cdo seksioni furnizohen nga kuadrot elektrike perkates.

Pajisjet e kondicionimi furnizohen me kabell me izolim dhe veshje PVC/PVC me tension izolimi 0.6 kV. Keto kablllo nepermjet saftit te mekanikes dalin ne taracen e godines. Shperndarja eshte bere me ndihmen e nje kanaline metalike te zinkuar ne te ngrohte dhe me kapak.

Furnizimi i ketyre paisjeve eshte bere nga seksioni “normal”.

Paisjet e brendshme të kondicionimit do të furnizohen nga kuadrot e kateve me kabell me izolim dhe veshje PVC/PVC me tension izolimi 450/750V. Instalimi i ketyre linjave është bërë nepermjet kanalave rrjete tavanore dhe nga kanalina deri tek paisja kablli është instaluar direkt në tavan.

#### **Paisjet e trajtimit të ajrit dhe ventilatoret.**

Paisjet e trajtimit të ajrit të cdo seksioni furnizohen nga kuadrot elektrike perkatese..

Pajisjet e kondicionimi furnizohen me kabell me izolim dhe veshje PVC/PVC me tension izolimi 0.6 kV. Këto kabllë nepermjet saftit të mekanikës dalin në taracën e godinës. Shpërndarja është bërë me ndihmën e një kanaline metalike të zinkuar në të ngrohtë dhe me kapak.

Furnizimi i ketyre paisjeve është bërë nga seksioni i “emergjences”

#### **Tokezimi dhe mbrojtja nga rrufete.**

Sistemet kanë për qëllim mbrojtjen e jetës humane, garantimin e funksionimit normal të sistemit elektrik dhe mbrojtjen e godinës nga goditjet atmosferike.

#### **Tokezimi i punës**

Në anën jugperendimore të godinës dhe ngjitur me murin mbajtes do të instalohen kater shufra tokezimi të zinkuara në të ngrohtë me gjatësi 1.5m. Distanca e montimit të shufrave të tokezimit ndërmjet tyre është 6m. Shufrat e tokezimit lidhen ndërmjet tyre me shirit të zinkuar në të ngrohtë me permasa 30x3mm.

Në këtë shirit është lidhur edhe ylli i gjeneratorit.

Duke shfrytëzuar hyrjet në godinë të kabllëve të gjeneratorit është mundësuar edhe hyrja në godinë e tokezimit të punës. Tokezimi i punës lidhet me kolektorin e tokezimit i cili do të instalohet në dhomën e transformatoreve në lartësi 50cm nga niveli i dyshemese perfundimtare.

Në këtë kolektor lidhet ylli i transformatoreve 800kVA. Dimensioi i kabllit të tokezimit të yllit të transformatorit tregohet në vizatimet perkatese.

Rezistenca e tokezimit të punës është me e vogël se  $2\Omega$ .

#### **Tokezimi ekuipotencial**

Për barazimin e potenciale elektrike në të gjithë pjesët metalike të ambjenteve elektrike si dhe të pajisjeve metalike në të cilat egziston mundësia të bien nën tension si dhe për menjanimin e diferencës së potencialeve në dysheme është instaluar sistemi i tokezimit ekuipotencial. Një percjelles i zhveshur bakri me gjatësi rreth 100m është instaluar në trasenë e kabllit të tensionit të mesëm. Ky percjelles është përdorur si tokezim ekuipotencial. Në rastë se dy tokezimet të bashkuara kanë një rezistencë tokezimi me të vogël se  $1\Omega$  këto tokezime janë të bashkuara.

#### **Ambientet elektrike.**

Në të gjitha ambientet elektrike është instaluar një kolektor tokezimi në lartësi 50cm nga dyshemeja perfundimtare. Në këtë kolektor lidhen të gjithë pjesët dhe pajisjet metalike që ndodhen në këto ambiente.

#### **Kanalinat metalike.**

Ne ndryshimet e niveleve dhe te drejtimit te kanalines ku eshte e pamundur lidhja e ngurte e kanalines per barazimin e potencialeve elektrike do te perdoren ura lidhese fleksibele me percjelle 16mm<sup>2</sup>.

### **Mbrojtja rrufe**

Ne baze te standartit EN-60235-2 dhe rendesise objekti ben pjese ne kategorine I te rezikut godites nga rrufeja.

Ne baze te kesaj perzgjedhjeje ne godine do te instalohet nje rrufeprites tip “pulsar” sic tregohet ne vizatimet perkatese.

Rrjeti zbrates i sistemit te mbrojtjes nga rrufeja eshte i dyfishte dhe do te ndertohet nga shirit percjelles tokezimi Cu 95mm<sup>2</sup>.

Per shkarkimin e ngarkesave elektrike gjate goditjes rrufe do te ndertohen dy tokezime te pavarura nje per cdo zbritje. Secili tokezim do te ndertohet nga elektroda tokezimi 1.5m te montuara ne largesi 6m ndermjet tyre.

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrole dhe matje periodike ne te gjitha pajisjet e sistemit, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Frekuenca (here vit)</b>
<b>1</b>	<b>Kontroll periodik viziv dhe riparim i celave te tensionit te mesem.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>12</b>
<b>2</b>	<b>Matje izolacioni tek celat e tensionit te mesem.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>3</b>	<b>Kontroll periodik viziv I transformatoreve 800 kVA</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>12</b>
<b>4</b>	<b>Matje izolacioni tek transformoret 800 kVA</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>5</b>	<b>Kontroll viziv dhe riparim i celave te mbrojtjes se transformatoreve.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>12</b>
<b>6</b>	<b>Matje periodike e karakteristikave te blloqeve te kondesatoreve.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>4</b>
<b>7</b>	<b>Kontroll viziv dhe riparim i kuadrit kryesor te tensionit te ulet</b>	<b>cope</b>	<b>1</b>	<b>12</b>

8	Matje izolacioni e kuadrit kryesor te tensionit te ulet.	cope	1	1
9	Kontroll periodik viziv dhe riparim i paneleve te tensionit te ulet	cope	28	12
10	Matje izolacioni tek panelet e tensionit te ulet.	cope	28	1
11	Kontrolli kontakteve dhe shterngimi I tyre tek panelet e tensionit te ulet.	cope	28	4
12	Kontroll periodik I filtrave te ajrit, vajit dhe naftes se gjeneratorit te emergjences 400 kVA	cope	1	2
13	Kontroll i nivelit te vajit dhe te ujit te motorit te gjeneratorit te emergjences.	cope	1	12
14	Kontrolli periodik dhe riparim i UPS 120 kVA	cope	2	12
15	Kontrolli periodik dhe riparim i UPS 20 kVA	cope	1	12
16	Kontrolli periodik dhe riparim i kuadrit kryesor te UPS-ve.	cope	1	12
17	Kontrolli periodik I sistemit te furnizimit 48 V (radrizatoret)	cope	1	12
18	Matja periodike e karakteristikave dhe sherbimi i grupit te baterive per UPS 120 kVA	cope	2	2
19	Matja periodike e karakteristikave dhe sherbimi i grupit te baterive per UPS 20 kVA	cope	1	2
20	Matja periodike e rezistences se tokezimit.	komplet	1	1

**Sistemi i mbyllur i kamerave dhe sistemi i sigurise (dedektimit i hyrjes ne godine).**

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrolle periodike dhe riparime te te gjitha pajisjeve te sistemit, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Frekuenca (here vit)</b>
<b>1</b>	<b>Kontroll dhe riparim I kamerave te instaluar ne godine (brenda dhe jashte)</b>	<b>cope</b>	<b>22</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i centralit monitorues NVR</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Kontroll dhe riparim i dedektoreve tip barier te instaluar jashte godines.</b>	<b>cope</b>	<b>6</b>	<b>2</b>
<b>4</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i sensoreve volumetrike te levizjes.</b>	<b>cope</b>	<b>36</b>	<b>2</b>
<b>5</b>	<b>Kontrolli periodik dhe riparim I sirenave te sigurise (te brendshme dhe te jashtme).</b>	<b>cope</b>	<b>7</b>	<b>2</b>
<b>6</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i sensoreve te dedektimit te ujit.</b>	<b>cope</b>	<b>42</b>	<b>2</b>
<b>7</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i kontakteve magnetike te deres.</b>	<b>cope</b>	<b>5</b>	<b>2</b>
<b>8</b>	<b>Kontroll periodik dhe riparim i paneleve te kontrollit te sigurise.</b>	<b>cope</b>	<b>6</b>	<b>2</b>
<b>9</b>	<b>Kontroll dhe riparim te sistemit te akses kontrollit (perfshire akses controllet 4 cope si dhe 12 reader te dyerve dhe 4 tripoda</b>	<b>cope</b>	<b>4</b>	<b>2</b>

## **Sistemi i transmetimit të dhenave dhe centrali telefonik i brendshëm**

Eshtë parashikuar ndertimi i një rrjeti kabllor i cili është në gjendje të mbulojë nevojat e godinës për telefoni dhe transmetimin e të dhenave si për rrjetin e brendshëm ashtu edhe furnizimet e jashtme nga rrjetet publike.

Projektimi i sistemit ka për qëllim kabllimet e sistemit brenda godinës terminimet dhe lidhjet e tyre në mënyrë që të ndërtohet një rrjetë fleksibel për transmetimin e të dhenave dhe telefonisë.

Rrjeti shpërndarës është pjesë përgjegjëse për transmetimin e saktë ndërmjet pjesëve aktive dhe si përfundim ndaj përdoruesit.

Pjesët përbërëse të sistemit:

- Pike lidhje me fiber optike tek vënderoja në hyrje të godinës.
- Lidhje me fiber optike ndërmjet dhomës së server-ave dhe 4 dhomave ku janë të vendosura patch-panelraketë
- Lidhjet kabllorë nga vendet e punës në drejtim të raketë
- Lidhjet e vendeve të punës të vecanta me serverat përkatës.

Përveç serverave të data me përdorim të përgjithshëm në godinë janë instaluar edhe serverat:

- Scada
- TLC
- TELEMETERING

Shpërndarja e rrjetit telefoni-data është në varesi të rrjetit që shërben. Në godinë janë instaluar rrjetet e mëposhtme:

- Rrjeti i transmetimit të dhenave dhe telefonisë
- Rrjeti i transmetimit të dhenave scada
- Rrjeti i transmetimit të dhenave TLC
- Rrjeti i transmetimit të dhenave TELEMETERING

## **Rrjeti i transmetimit të dhenave dhe telefonisë**

Në katin përfaqësues të seksionit të OST janë instaluar serverat e shkëmbimit të dhenave. Në katet përfaqësues të katinës së parë dhe të dytë janë të vendosur kabinetet *rack* të data-telefonit. Secili nga raketët është i ndarë në mënyrë fizike në seksionin të data dhe në seksionin e telefonisë. Secili nga seksionet e cdo raku lidhet me dhomen e server-ave duke shfrytëzuar fiber optike *multi mode*. Furnizimi i vendeve të punës realizohet për rrjetin të data me kabell FTP Cat 6, ndërsa për telefonat e vendeve të punës realizohet me kabell UTP Cat 5. Kabllotë janë të instaluar në kanalinen e rrjeteve të rrymave të dobëta dhe në hapësirën e përbashkët janë të instaluar në kanaline të vecanta.

### **Rrjeti i te dhenave SCADA**

Ky rrjet ndertohet ne te njeften menyre si rrjeti data. Ai eshte me kabell FTP Cat 6. Kabllot jane te instaluar ne kanalinen metalike rrjete te rrymave te dobeta qe eshte instaluar poshte dyshemese se ngritur dhe me guaine ose tub fleksibel nga kanalina deri tek vendi i punes. Racku i serverave eshte i instaluar ne katin perdhe ne ambientin “scada” seksioni CNC.

**Rrjeti i te dhenave TLC**  
Ky rrjet eshte i dizenuar ne te njeften menyre si rrjeti data. Ai eshte me kabell FTP Cat 6. Kabllot jane te instaluar ne kanalinen metalike rrjete te rrymave te dobeta qe eshte instaluar poshte dyshemese se ngritur dhe me guain ose tub fleksibel nga kanalina deri tek vendi i punes. Racku i serverave data eshte i instaluar ne katin perdhe ne ambientin “TLC” seksioni CNC.

### **Rrjeti i te dhenave Telemetry**

Ky rrjete eshte i dizenuar ne te njeften menyre si rrjeti data. Ai eshte me kabell FTP Cat 6. Kabllot jane te instaluar ne kanalinen metalike rrjete te rrymave te dobeta qe eshte instaluar poshte dyshemese se ngritur dhe me guaine ose tub fleksibel nga kanalina deri tek vendi i punes. Racku i serverave data eshte i instaluar ne katin perdhe ne ambientin “TELEMETERING” seksioni OST.

### **Sistemi i ashensoreve**

Ne godine jane intaluar kater ashensore me kapacitet 450 kg (6 persona). Keta ashensore jane instaluar nga 2 per secilin seksion te godines. Operimi i tyre eshte per te tre katet e godines (-1,0 dhe 1).

### **Sistemi i dyerve automatike te godines**

Ne godine jane te instaluar tre porta me komandim automatik. Porta e pare eshte ajo e jashtme, e cila komandohet automatikisht nga godina e vendrojes qe ndodhet aty prane. Kjo porte sherben per lejimin e hyrjes se makinave dhe njerezve nga rruga ne parkimin e brendshem te godines.

Porta tjeter perbehet nga dy porta te lehta rreshqitese ( secila me peshe deri ne 125 kg) me kontroll me mikroprocesore, te cilat sherbejne per hyrjen e personave nga oborri i godines ne brendesi te saj.

Pas kesaj porte jane instaluar kater porta te tjera te tipit te rrotullueshme me tre kembe. Keto jane instaluar nga dy porta per secilin seksion te godines. Keto porta komandohen me kartat personale te punonjesve.

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrole periodike dhe riparime te te gjitha pajisjeve te sistemit, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Frekuenca (here vit)</b>
<b>1</b>	<b>Lubrifikimi I motorit te deres levizese te jashtme.</b>	<b>cope</b>	<b>1</b>	<b>1</b>



2	<b>Kontroll dhe riparim I sensoreve te pozicionit.</b>	cope	2	2
3	<b>Kontrolli I pjeseve mekanike kremalier - pinjon</b>	cope	1	2
4	<b>Lubrifikimi i motoreve te dyerve te lehta rreshqitese ne hyrje te godines.</b>	cope	2	1
5	<b>Kontroll dhe riparim I sensoreve te pozicionit.</b>	cope	4	2
6	<b>Kontrolli I shinave ku leviz porta.</b>	cope	2	2
7	<b>Kontroll dhe riparim I mekanizmit te portave te rrotullueshme</b>	cope	4	2
8	<b>Mirembajtje e traut hyres</b>	set	1	4

**Sherbime te tjera te godines (punime ndertimore).**

Gjate periudhes se sherbimit kontratori duhet te kryeje kontrole periodike dhe riparime te gjithë pjeseve ndertimore te godines, si dyer, dritare, dysheme, etj, ne menyre qe ato te funksionojne ne menyre korrekte.

Keto sherbime qe duhet te kryeje kontratori jepen ne tabelen e meposhtem, ne te cilen rekomandohet edhe frekuenca me te cilen duhet te kryhen keto sherbime.

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Frekuenca (here vit)
1	<b>kontroll viziv dhe riparim I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dyer druri.</b>	cope	112	1
2	<b>kontroll viziv dhe riparim I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dyer metalike.</b>	cope	13	1
3	<b>kontroll viziv I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dyer emergjence..</b>	cope	6	1

<b>4</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim I fleteve mbledhese per dyert qepen.</b>	<b>cope</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>5</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim I menteshave, dorezave dhe pjeseve te tjera per dritaret.</b>	<b>cope</b>	<b>129</b>	<b>1</b>
<b>6</b>	<b>kontroll viziv dhe riparim per difekte te tavanit te plote te gipsit.</b>	<b>m2</b>	<b>3500</b>	<b>1</b>
<b>7</b>	<b>kontroll per demtim dhe riparim I pllakave te tavanit modular 60x60.</b>	<b>m2</b>	<b>2650</b>	<b>1</b>
<b>8</b>	<b>kontroll per demtim dhe riparim i pllakave te dyshemese</b>	<b>m2</b>	<b>3308</b>	<b>1</b>
<b>9</b>	<b>kontroll per demtim dhe riparim i dyshemese teknike</b>	<b>m2</b>	<b>4400</b>	<b>1</b>
<b>10</b>	<b>kontroll per demtime i dyshemese parket</b>	<b>m2</b>	<b>460</b>	<b>1</b>
<b>11</b>	<b>kontroll per demtim dhe riparim i mureve te suvatuara.</b>	<b>m2</b>	<b>15900</b>	<b>1</b>

### **Sistemi i ventilimit per sallën e Dispeçerisë**

Sistemi i ventilimit i instaluar nuk është efikas, sepse mungon tubacioni i heqjes së ajrit të prishur si edhe sasia e ajrit të freskët ( $1500 \text{ m}^3 / \text{orë}$ ) që futet është e vogël dhe si rrjedhojë ajri i sallës ndërrohet një herë në orë.

Bazuar në vlerësimet e bëra nga grupi i punës dhe rëndësinë që ka salla e dispeçerisë, do të duhet të instalohet një sistem të ri ventilimi me kapacitet  $5000 \text{ m}^3/\text{orë}$ . Preventivi i punimeve që do të kryhen është dhënë në dokumentin: “Tabela e mirëmbajtjes së godinës”.

Duke qenë se do të kryhen punime ndërtimore brenda godinës së OST-së dhe në vende ku janë instaluar edhe rrjete të tjera inxhinjrike dhe me qëllim që të mos kemi dëmtime gjatë kryerjes së punimeve duhet që:

- Kompanitë që do të shprehin interesin për të marrë pjesë në garë do të duhet që para se të japin ofertën të bëjnë një vizitë pranë zyrave të OST-së në një datë të paracaktuar, me

qëllim që ti shpjegohen me hollësi aktivitetet që do të kryhen. Kjo do të ndihmojë në përcaktimin e metodologjisë së duhur për kryerjen e punimeve.

- Pas kryerjes së punimeve çdo gjë do të rikthehet në statusin që kishte para fillimit të punimeve.

Specifikimet teknike të pajisjeve dhe materialeve:

8. Shkëmbyes nxehtësie  $Q=5000\text{m}^3/\text{h}$ ,  $P=400\text{Pa}$ , fuqia e motorit të ventilatorëve 1,5 kW dhe parangrohësi me fuqi  $N=25\text{kW}$ . Shkëmbyesi i nxehtësisë do jetë me fletë alumini, muret dyshe me materiale termoizoluese dhe i pajisur me rezistencë elektrike.
9. Tubi i dërgimit dhe i kthimit do të jenë prej materiali çelik i zinkuar, të termoizoluar me trashësi  $\delta = 0,6\text{mm}$  dhe diametër  $\Phi 450\text{ mm}$ .
10. Termoizolimi për tubacionet do të jetë tip i gomuar me trashësi  $\delta = 9\text{mm}$ .
11. Grila alumini 60x20 cm me 2R.
12. Brryla 450mm, rrethor  $90^\circ$ , me tre segmente
13. Aksesore për montimin e linjave të dërgimit dhe kthimit. Shufra të filetura, bullona, profile L, nastro alumini, perçina,.. etj.
14. Punimet elektrike do të përbëhen nga furnizim vendosje:
  - Lëshues elektromagnetik 63A,3F
  - Automat 63 A,3F, 4P
  - Kabëll 4x10mm, 25 kW
  - Tel 10mm
  - Nëse do të ketë nevojë për ndonjë përshtatje tjetër të panelit elektrik ato do të kryhen nga kontratori pa kosto shtesë.

### III. Bazat e termave të references (Objektivat)

Detyra e kompanisë që do të kryejë mirëmbajtjen e Impjanteve të godinës është që të gjitha sistemet të përshkruara këtu me sipër të funksionojnë në mënyrë korrekte dhe të panderprerë duke siguruar kështu optimizimin e kushteve të punës, duke plotësuar objektivat e mëposhtme:

- Funksionimi korrekt, panderprerje dhe në kushte sigurie të gjitha sistemeve të godinës të përshkruara këtu me sipër.
- Kryerja e të gjithë procedurave të mirëmbajtjes në një kohë që nuk ndërferojnë me aktivitetin e kryer në godinë nga ana e punonjësve të kompanisë OST.
- Mbajtja e një performancë të lartë operimi të të gjithë sistemeve edhe pas nderhyrjeve profilaktike që do të kryhen.
- Trajnimi i punonjësve të dedikuar të OST-se për mirëmbajtjen e sistemeve të sipërcituara.

### IV. Qëllimi i punës së shërbimit që do të ofrohet

Këto terma reference mbulojnë qëllimin e shërbimit që do të ofrohet dhe strukturën e këtij shërbimi të detajuar për çdo sistem të godinës.

3. Shërbime periodike në të gjitha sistemet konform manualeve të operimit dhe mirëmbajtjes.
4. Raportimi periodik me shkrim i të gjitha nderhyrjeve të kryera, duke hapur libra të posaçëm pune për secilin sistem. Këto libra do të vendosen në çdo kohë në dispozicion Administratorit të Kontrates dhe në përfundim të kontrates do të mbeten OST-se.

Aktivitetet e kryera do të konsistojnë në shërbime periodike të sistemeve, në furnizimin dhe vendosjen e materialeve të konsumueshme që shërbejnë për operimin korrekt të impianteve si edhe në furnizimin dhe vendosjen e pjesëve të demtuara, të cilat do të jepen në një listë të veçantë në dokumentat e tenderit. Të gjitha këto shërbime do të kryhen konform manualeve të operimit dhe mirëmbajtjes për çdo sistem.

Investitori do të verë në dispozicion të kompanisë fituese të gjitha materialet teknike të nevojshme për mirëmbajtjen e sistemeve të përkruara. Këto materiale do të përfshijnë të gjitha vizatimet përfundimtare të sistemeve si edhe manualët e operimit dhe mirëmbajtjes.

Nga ana e investitorit do të caktohet një person përgjegjës “Administratori i Kontrates”, i cili do të mbajë kontaktet me kompaninë që do të kryejë shërbimin e impianteve të godinës dhe do të certifikojë çdo punë të saj.

Kontratori duhet të paraqesë gjithmone një skedul kohor të aktiviteteve që do të kryejë, i cili duhet të miratohet nga investitori.

Në tabelën bashkelidhur do të përkruajmë të gjitha aktivitetet që do të kryhen për çdo sistem.

## **V. Kërkesat për ekspertizë**

Kompania që do të kryejë shërbimin e sistemeve të lartpërmendura duhet që të ketë një eksperiencë disavjeçare në këtë fushë. Ajo duhet që të ketë realizuar me sukses kontrata shërbimi të impianteve të ventilimit dhe ajrit të kondicionuar, impianteve hidraulike, impianteve të mbrojtjes kundër zjarrit dhe impianteve elektrike të tensionit të mesëm e të ulët. Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit të ashensoreve mund të kryhet edhe nga kompani nenkontratore të specializuara. Kërkesat për ekspertizë për kompaninë që do të kryejë punimet për instalimin e sistemit të ventilimit për sallën e dispeçerisë do të gjenden në dokumentat e tenderit.

Shërbimi do të konceptohet duke patur dy persona fiks çdo ditë në godinë dhe persona të tjerë eksperte të sistemeve të lartpërmendura të cilat do të nderhyjnë në kohën e duhur për zgjidhjen e problemeve.

Njeri prej personave që do të jetë fiks në godinë do të monitorojë të gjithë funksionimin e sistemeve të godinës nga njesia kompjuterike BMS, ndërsa tjetri do të monitorojë fizikisht të gjitha sistemet dhe do të nderhyjë në rast se do të ketë probleme. Këta persona duhet të jenë të specializuar dhe të kenë aftësitë e mëposhtme:

- Te kene aftesi te mira kompjuterike dhe te njohin monitorimin dhe operimin e sistemeve ne distance, pasi do te punojne tek njesia kompjuterike, e cila manaxhon te gjitha sistemet e godines.
- Te jene te afte qe te vene ne pune te gjitha sistemet qe mund te kalojne ne gjendje alarmi ose “trip”, duke kryer nderhyrjet e kerkuara per çdo rast.
- Te kene nje certifikate e cila i autorizon qe te operojne me sistemin e antizjarrit.

Kompania duhet te kete kapacitete te mjaftueshme teknike per te kryer nderhyrjet e duhura ne te gjitha sistemet si edhe per kryerjen e sherbimeve periodike sipas programit te miratuar.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Operatori i sistemit të transmetimit (OST sh.a.)**

**Shenim: Në respekt të nenit 23 të LPP – së, në të gjithë rastet kur në Specifikimet Teknike përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.**

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

